

RAPORT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOSOVË:
MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT
NË INSTITUCIONE

Neni 5 [Gjuhët]
Neni 24 [Barazia para ligjit]

RAPORT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOSOVË: MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT NË INSTITUCIONE

Porositës i raportit:
OJQ Aktiv

Donator:
Këshilli i Evropës

Autorë:
Goran Avramović, Zoran Savić dhe Miodrag Milićević
Bashkautorë:
Iniciative e Re Sociale/Nova društvena inicijativa (NSI), Radio Goraždevac,
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) dhe
Qendra Mediale në Çagllavicë

Për botuesin:
OJQ Aktiv

Adresa:
Kralja Petra 183a, Mitrovicë e Veriut

Email: info@ngoaktiv.org
Uebisajti: www.ngoaktiv.org

MITROVICË, SHTATOR 2025



Ky hulumtim është mbështetur nga Këshilli i Evropës Zyra në Prishtinë në kuadër të projektit "Nxitja e kohezionit shoqëror përmes fuqizimit të të drejtave të pakicave kombëtare dhe përdorimit të gjuhëve", zbatuar nga Këshilli i Evropës Zyra në Prishtinë. Opinionet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

PËRMBAJTJA

Pjesa hyrëse	4
Hyrje	5
Situata aktuale dhe arsyet për kryerjen e monitorimit	6
Metodologjia	7
Gjetjet kryesore të raportit	9
Korniza analitike	10
Konteksti juridik dhe institucional	11
Implementimi i kufizuar i normave ligjore	13
Zyra e Komisionerit për Gjuhët	14
Arsimi dhe politika gjuhësore	16
Sistemi arsimor dhe dygjuhësia	17
Albanologjia në Beograd dhe Ballkanistika në Prishtinë	18
Mundësitë për të mësuar gjuhët në mënyrë të pavarur	19
Modelet dhe praktika krahasuese	20
Pasqyrë krahasuese: Gjuhët zyrtare në të drejtën krahasuese	21
Praktika institucionale dhe monitorimi	22
Gjetjet e detajuara të monitorimit tremujor: Pasqyrë sipas institucionit	24
Raporti me mediat	40
Shembuj të praktikave pjesërisht të mira dhe të mira	46
Përfundime dhe rekomandime	47
Përfundime	48
Rekomandime	49

PJESA HYRËSE

Në shoqëritë me diversitet të theksuar etnik dhe gjuhësor, të drejtat gjuhësore përfaqësojnë një nga themelet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe janë çelës për arritjen e barazisë për të gjitha komunitetet. Në Kosovë, ku serbishtja dhe shqipja njihen ligjërisht si gjuhë zyrtare, e drejta për gjuhë është zyrtarisht e garantuar nga Kushtetuta¹ dhe një kornizë legjislative e posaçme, ku në radhë të parë shquhet Ligji për përdorimin e gjuhëve.² Megjithatë, pavarësisht dispozitave të qarta normative, gjuha serbe po shpërfillet, shtypet dhe marginalizohet sistematikisht gjithnjë e më shumë në praktikën institucionale. Praktika të tilla jo vetëm që minojnë besimin e komuniteteve jo-shumicë ndaj institucioneve, por gjithashtu kontribuojnë në përjashtimin e tyre shoqëror, e bëjnë më të vështirë qasjen në shërbimet publike dhe thellojnë ndasitë ekzistuese shoqërore.

Ky raport, i cili është produkt i bashkëpunimit ndërmjet OJQ Aktiv, Radio Kim, Nova društvena inicijativa/Inicativës së Re Sociale (NSI), Radio Goraždevac, Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) dhe Qendrës Mediale në Çagllavicë, ka për qëllim hartëzimin dhe analizimin gjithëpërfshirës të praktikave institucionale në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Publikimi i këtij raporti është mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përmes projektit “Nxitja e kohezionit shoqëror përmes forcimit të të drejtave dhe gjuhëve të komuniteteve pakicë”. Përmes monitorimit të detajuar të niveleve të ndryshme të pushtetit, institucioneve dhe agjencive publike, raporti identifikon mangësitë kryesore në aplikimin e detyrimeve ligjore, evidenton dobësitë sistemore dhe nxjerr në pah shembuj të praktikave të mira të cilat, ndonëse të rralla, dëshmojnë se aplikimi konsistent i ligjit është i mundur kur ka vullnet politik, përgjegjësi institucionale dhe ndërgjegjësim për rëndësinë e respektimit të të drejtave gjuhësore. Kjo është arsyeja pse qëllimi i raportit nuk është vetëm të dokumentojë situatën faktike, por edhe të ofrojë një bazë të fortë për të avokuar për ndryshime sistemore që do të çonin në një aplikim më konsistent dhe efikas të barazisë gjuhësore, gjithmonë në përputhje me normat ligjore në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. E drejta për gjuhë është një nga të drejtat themelore të njeriut, e lidhur në mënyrë të pamohueshme me identitetin, dinjitetin dhe barazinë. Për komunitetet jo-shumicë, mundësia për të përdorur gjuhën e tyre në komunikim me institucionet nuk është privilegj, por parakusht për të pasur qasje në shërbime publike, arsim, kujdes shëndetësor, drejtësi dhe segmente të tjera kyç të jetës shoqërore. Përjashtimi gjuhësor çon në barriera informative dhe administrative, një ndjenjë padukshmërie dhe pasigurie, të cilat në planin afatgjatë dëmtojnë parimet e përfshirjes dhe kohezionit social. Prandaj, barazia gjuhësore është parakusht për ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, transparente dhe demokratike, në të cilën të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia etnike ose gjuhësore, kanë qasje të barabartë në informacion dhe institucione. Në një shoqëri pas konfliktit si Kosova, respektimi i të drejtave gjuhësore luan rol të posaçëm në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë.

Me këtë raport, duam të krijojmë hapësirë për dialog mbi këto çështje dhe të ofrojmë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave ekzistuese, në mënyrë që ato të jenë plotësisht në përputhje me detyrimet legjislative. Shpërfaqja e qartë e mangësive dhe avokimi konstruktiv mund të kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e një kulture institucionale më përfshirëse dhe në forcimin e llogaridhënies ndaj të gjithë qytetarëve, pa përjashtim.

¹ <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/Ustav-Republike-Kosova.pdf>

² https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ZAKON_BR_02_L-37_O_UPOTREBI_JEZIKA1346.pdf

SITUATA AKTUALE DHE ARSYET PËR KRYERJEN E MONITORIMIT

Zbatimi i këtij monitorimi është motivuar nga prania gjithnjë e më e theksuar e praktikës së shpërfilljes së detyrimit ligjor për komunikim dygjuhësor në punën e institucioneve publike në Kosovë. Ndonëse ligji përcakton qartë detyrimet në lidhje me përdorimin e gjuhës serbe dhe shqipe si gjuhë zyrtare të barabarta, në praktikë, shpërfillja sistematike e gjuhës serbe në komunikimin publik është gjithnjë e më e dukshme, veçanërisht në hapësirën digjitale dhe gjatë publikimit të informacionit me rëndësi publike. Shqetësim të posaçëm përbën mungesa e dokumenteve të rëndësishme në gjuhën serbe, duke përfshirë konkurset për punësim, shpalljet publike, vendimet, rregulloret, udhëzimet administrative dhe aktet e tjera ligjore. Edhe kur janë formalisht të qasshme, ato shpesh janë të paplota, sipërfaqësore ose të përkthyer në mënyrë të pasaktë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në të drejtën e komuniteteve jo-shumicë për t'u informuar me kohë dhe në mënyrë adekuate.

Veçanërisht shqetësuese është praktika gjithnjë e më e përhapur e përdorimit të përkthimeve të automatizuara në komunikimin zyrtar. Këto përkthime shpesh janë të palexueshme, me gabime gramatikore dhe të pasakta nga aspekti terminologjik, duke mos mundësuar kështu një kuptim të qartë të përmbajtjes. Kjo praktikë nuk përbën vetëm lëshim teknik, por shkel rëndë të drejtën për qasje të barabartë në informacion, e cila është një e drejtë themelore e njeriut, e garantuar nga legjislacioni i Kosovës dhe standardet ndërkombëtare. Kur institucionet komunikojnë ekskluzivisht ose kryesisht në një gjuhë, qytetarët që përdorin një gjuhë tjetër zyrtare de facto përjashtohen nga rrjedhat institucionale, gjë që thellon më tej ndasitë sociale dhe minon besimin në strukturat publike. Prandaj, ekziston një nevojë e qartë për monitorim sistematik të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, me qëllim identifikimin e modeleve të sjelljes institucionale, identifikimin e vendeve ku detyrimet ligjore shkelen më shpesh, si dhe ofrimin e një baze për avokim në të ardhmen që do të çonte në një përfshirje më të madhe gjuhësore, llogaridhënie më të madhe dhe punë më transparente të institucioneve të Kosovës.

Monitorimi i pajtueshmërisë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Kosovë u krye nga marsi deri në qershor 2025, me qëllim përcaktimin e shkallës në të cilën institucionet po i përmbushin detyrimet e tyre ligjore në lidhje me barazinë gjuhësore të gjuhës serbe dhe gjuhës shqipe, të cilat përcaktohen si gjuhë zyrtare në të gjithë territorin e Kosovës.

Si pjesë e fazës pilot të monitorimit, u krye një analizë e dhjetë uebsajteve zyrtare dhe llogarive përkatëse në media sociale të institucioneve kryesore në nivel qendror dhe lokal. Në monitorim u përfshinë këto institucione: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Gjykata Kushtetuese, organizata joqeveritare, Ministria e Ekonomisë, Kuvendi i Kosovës dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Përveç komunikimit digjital, raporti përfshin edhe një segment të veçantë që lidhet me marrëdhëniet institucionale ndaj mediave, me fokus në disponueshmërinë e informacionit për mediat që raportojnë në gjuhën serbe. Në veçanti, u shqyrtua nëse përgjigjet për pyetjet gazetareske janë të disponueshme edhe në serbisht, cila gjuhë përdoret për të komunikuar përmes njoftimeve për publikun, si dhe nëse institucionet u ofrojnë informacion në mënyrë të barabartë mediave që raportojnë në serbisht dhe shqip. Për të siguruar konsistencë në analizë, u aplikuan kritere vlerësimi të përcaktuara qartë, të ndara në disa kategori:

Përputhshmëria gjuhësore dhe proporcionaliteti i përmbajtjes.

Me këtë është vlerësuar konsistenca dhe proporcionaliteti i përmbajtjes ndërmjet versioneve shqipe dhe serbe të uebsajteve. Kjo ka përfshirë verifikimin nëse informacionet publikohen njëkohësisht në të dyja gjuhët, nëse përmbajtjet janë të njëjta për nga masa dhe rëndësia, si dhe nëse ka dallime në qasjen në dokumente ose seksione të caktuara të sajtit në varësi nga gjuha.

Cilësia e përkthimit. Cilësia e përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën serbe është veçuar si segment posaçërisht i rëndësishëm i analizës. Në vlerësim është përfshirë: lexueshmëria, saktësia e terminologjisë, korrektesia gramatikore, stili, si dhe përdorimi konsistent i terminologjisë administrative dhe juridike. Megjithatë, është vërejtur se në një numër të madh rastesh përdoren përkthime automatike, të cilat më pas nuk i janë nënshtruar një lektorimi adekuat.

Disponueshmëria e dokumenteve me rëndësi kyç. Në kuadër të secilit sajt është analizuar disponueshmëria e dokumenteve me rëndësi publike, të cilat qytetarët i përdorin për realizimin e të drejtave të tyre. Këtu përfshihen ligjet, aktet nënligjore, udhëzimet administrative, konkurset për punësim, shpalljet publike, subvencionet, grantet dhe forma të tjera të mbështetjes institucionale. U vlerësua nëse këto dokumente ishin të disponueshme në gjuhën serbe në të njëjtin format si në gjuhën shqipe.

Në kuadër të monitorimit, institucioneve të analizuarat iu dërgua një pyetësor shtesë me pyetje që lidheshin me numrin e përgjithshëm të të punësuarve, përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në mesin e të punësuarve, si dhe numrin e përkthyesve të kualifikuar që kanë në dispozicion. Të dhënat e mbledhura u analizuan më pas në mënyrë sasiore dhe cilësore, me qëllim identifikimin e dobësive kryesore tematike dhe të modeleve të mosrespektimit të detyrimeve ligjore, por edhe për të evidentuar shembuj pozitivë që mund të shërbejnë si modele të praktikave të mira.

Aplikimi i metodologjisë së zgjedhur ka mundësuar që në mënyrë të qartë dhe krahasuese të paraqitet shkalla e përputhshmërisë së komunikimit institucional me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Vëmendje e posaçme i është kushtuar pasojave të diskriminimit gjuhësor në qasjen në informacion, transparencën e punës së institucioneve dhe realizimin e të drejtës së qytetarëve për t'u informuar në gjuhën e tyre.

GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

Mosrespektim sistematik i Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Monitorimi ka treguar se institucionet e Kosovës shpeshherë nuk sigurojnë përkthime ose i ofrojnë ato në cilësi aq të dobët saqë bëhen të pakuptueshme, gjë që përbën shkelje të rëndë të ligjit dhe të drejtave themelore të njeriut. Koncretisht, neni 2 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve thotë: "2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës. 2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës."³

Diskriminim institucional përmes praktikës gjuhësore – mohimi i përkthimit bën që komunitetet jo-shumicë të mos kenë qasje të barabartë në informacionet me rëndësi publike, duke minuar kështu barazinë, transparencën dhe sundimin e ligjit.

Mungesë konsistence në disponueshmërinë e dokumenteve me rëndësi kyç – konkurset për punësim, shpalljet për subvencione dhe programet e mbështetjes shpesh nuk janë të disponueshme në të dyja gjuhët zyrtare; numri i dokumenteve në serbisht është dukshëm më i vogël, gjë që e bën qasjen të pabarabartë.

Cilësi e ulët e përkthimeve ekzistuese – edhe kur dokumentet ekzistojnë në të dyja gjuhët, përkthimet shpesh përmbajnë gabime gramatikore dhe terminologjike, madje edhe pasaktësi përmbajtjesore

Kontrasti me praktikën e organizatave joqeveritare – megjithëse kanë buxhete dukshëm më të vogla dhe dukshëm më pak burime njerëzore, OJQ-të nga komuniteti serb në veri të Kosovës sigurojnë vazhdimisht përkthime cilësore në tri gjuhë, duke dëshmuar se faktor kyç nuk janë burimet financiare, por vullneti dhe organizimi institucional.

Mungesë e kapaciteteve të kualifikuara njerëzore për përkthim – analiza e përgjigjeve të ministrive dhe agjencive zbuloi një hendek të madh midis mjeteve buxhetore dhe numrit të përkthyesve të angazhuar. Në disa institucione, siç është Ministria e Punëve të Brendshme me një buxhet prej 216 milionë euro në vitin 2024, të gjitha punët e përkthimit kryhen nga një person i vetëm.

³ https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ZAKON_BR_02_L-37_O_UPOTREBI_JEZIKA1346.pdf

KORDIZA ANALITIKE

E drejta për gjuhë dhe qasje të barabartë në informacion njihen dhe mbrohen në një sërë instrumentesh ndërkombëtare, ndër të cilat veçanërisht dallohen:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)⁴ – neni 2 (ndalimi i diskriminimit) dhe neni 7 (barazia para ligjit dhe e drejta për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim).

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950)⁵ – neni 10 (liria e shprehjes, e cila përfshin të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacion), interpretuar në lidhje me ndalimin e diskriminimit nga neni 14.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)⁶ – neni 19 (e drejta për lirinë e shprehjes, që përfshin të drejtën për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion) dhe neni 27 (të drejtat e anëtarëve të pakicave për të përdorur gjuhën e tyre).

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare (1995) – veçanërisht neni 10 (e drejta për përdorimin e gjuhës së pakicës para autoriteteve) dhe neni 11 (e drejta për emra personale, shenja dhe toponime në gjuhën e pakicës).

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (1992)⁸ – detyron shtetet të sigurojnë përdorimin e gjuhëve të komuniteteve pakicë në jetën publike, para organeve të pushtetit dhe në ofrimin e shërbimeve.

Deklarata e OKB-së për të drejtat e personave pjesëtarë të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore (1992)⁹ – neni 2, që konfirmon të drejtën e pakicave për të përdorur gjuhën e tyre në mënyrë të papenguar, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve që i prekin ato.

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore (2000) – neni 21 (ndalimi i diskriminimit, përfshirë diskriminimin me bazë gjuhësore) dhe neni 22 (respektimi i diversitetit kulturor, fetar dhe gjuhësor).

⁴ <https://minlmpdd.gov.rs/wp-content/uploads/2024/07/univerzal-nadeklaracijalat.pdf>

⁵ https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_srp

⁶ <https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/o5bosniak/BIIntCovCivilPoliticalRights.pdf>

⁷ <https://minlmpdd.gov.rs/sektori/nacionalne-manjine/multilateralni-ugovori/okvirna-konvencija-za-zastitu-nacionalnih-manjina/>

⁸ https://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Source/CharterText/ExplRpt_ba.pdf

⁹ <http://mail.hnv.org.rs/docs/DEKLARACIJA%20O%20PRAVI-MA%20OSOBA.pdf>

¹⁰ https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2023/22S-rbN_SWD_2023_692%20Kosovo%20report.pdf

¹¹ https://www.assembly-kosova.org/Uploads/Data/Files/6/UstavRepublikeKosovo_4NLeWNWqGD.pdf

Problemi i shkeljes sistematike të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë është evident për një kohë të gjatë, por ai vazhdon të ekzistojë pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese që garanton përdorimin e barabartë të gjuhës serbe dhe gjuhës shqipe. Si pasojë, anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që përdorin gjuhën serbe mbeten në mënyrë të vazhdueshme të privuar nga informacione me rëndësi kyç që ofrohen me kohë. Ky fakt konfirmohet edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2023, ku disa herë theksohet ky problem (faqet 28, 33, 35 dhe 38). Një praktikë e tillë pengon informimin e barabartë të anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, i cili përcakton qartë se gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare të barabarta në Kosovë. Praktika shumëvjeçare e shpërfilljes së këtij problemi dhe heshtja institucionale përballë shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave gjuhësore çon në situatën ku qytetarët e kombësisë serbe, si dhe anëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë që mbështeten në informacionet e disponueshme në gjuhën serbe, mbeten të privuar nga të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje. Sipas Kushtetutës së Kosovës, shteti përkufizohet si shumetnik, ndërsa shoqëria karakterizohet si qytetare, jo etnike apo kombëtare. Kushtetuta gjithashtu garanton lirinë e shprehjes, të besimit fetar dhe të tubimit, ndër të tjera të drejta themelore.

Gjuha serbe përkufizohet si zyrtare dhe, sipas ligjit, e barabartë me gjuhën shqipe, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

E drejta për përdorimin e gjuhës është sqaruar më tej me Ligjin për përdorimin e gjuhëve,¹² i cili është adoptuar në Kosovë në korrik 2006. Ky ligj përcakton udhëzime të rrepta për sigurimin e dygjuhësisë në punën e institucioneve të Kosovës, dhe aplikimi i tij parashikohet edhe në disa segmente të sektorit privat. Veçanërisht i rëndësishëm është Pjesa e Tretë (Të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre), i cili lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve nga diskriminimi. Ky kapitull garanton të drejtën e anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë për të zhvilluar dhe avancuar identitetin dhe veçantitë e tyre specifike, duke përfshirë të drejtën për të shprehur dhe ruajtur kulturën dhe traditën, për t'u arsimuar në gjuhën amtare, për të përdorur simbolet e komunitetit, alfabetin e tyre, përfaqësimin në përmbajtjet mediatike, si dhe krijimin e lidhjeve me shtetet që ndajnë kulturën dhe trashëgiminë e tyre.

¹² https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ZAKON_BR_o2_L-37_O_UPOTRE-BI_JEZIKA1346.pdf

IMPLEMENTIMI I KUFIZUAR I NORMAVE LIGJORE

Ndonëse neni 14 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare¹³ (nr. 02/L-37) përcakton qartë detyrimin e gjykatave për të lëshuar dokumente që lidhen me procedurat në gjuhën e zgjedhur si zyrtare në një procedurë të caktuar, në praktikë vendimet gjyqësore kryesisht lëshohen në gjuhën shqipe. Këto praktika çojnë në shkelje të të drejtave të qytetarëve nga komunitetet jo-shumicë, gjë që konfirmohet nga shembuj të shumtë të dokumentuar në studimet e kryera nga organizatat e shoqërisë civile.¹⁴ Mes të tjerash, është shënuar një rast i shfuqizimit të një kontrate bankare të nënshkruar me shkrimin cirilik, si dhe shembuj të shumtë ku prokurimet publike dhe konkurset për punësim nuk janë përkthyer në gjuhën serbe, duke kufizuar kështu mundësinë e barabartë për punësim dhe avancim profesional për qytetarët që nuk flasin ose nuk kuptojnë gjuhën shqipe. Shembuj të tillë pikasin një problem më të gjerë dhe sistemor të mosrespektimit të parimit të dygjuhësisë në nivel institucional.

Analizat tregojnë se problemi nuk qëndron vetëm në aplikimin jo-konsistent të ligjit, por edhe në mungesën e vullnetit dhe kapacitetit institucional për zbatimin e tij. Institucionet e Kosovës shpesh përdorin diskrecionin për të vendosur vetë në cilën gjuhë do të kryejnë procedurat ose publikojnë dokumentet, ndërsa qytetarët detyrohen më pas të kërkojnë përkthimin. Korniza legjislative nuk përmban garanci të qarta se përkthimet do të sigurohen brenda një afati të caktuar, as standarde që do të siguronin cilësinë e tyre. Për më tepër, mungesa e investimeve sistematike në arsimimin dhe punësimin e stafit që zotëron të dyja gjuhët gjatë dekadave të kaluara ka rezultuar në mungesë kronike të përkthyesve të kualifikuar dhe stafit administrativ të aftë për të mundësuar aplikimin e ligjit në mënyrë konsistente. Si pasojë e kësaj situate, ndodh i ashtuquajti "tokenizëm" – respektimi formal i të drejtës për gjuhë përmes veprimeve simbolike ose të pjesshme, pa një qëllim të mirëfilltë për realizimin e saj të plotë. Në diskursin politik, e drejta për përdorimin e gjuhës serbe shpeshherë interpretohet si privilegj, dhe jo si e drejtë e garantuar me ligj. Në këtë mënyrë krijohet një klimë politike të pafavorshme, e cila normalizon mosrespektimin e ligjeve në fuqi dhe të Kushtetutës.

Korniza ligjore e Kosovës formalisht parashikon sanksione për shkeljen e së drejtës për gjuhë. Neni 193. Kodi Penal i Kosovës parashikon gjoba dhe dënime me burg për personat që ua mohojnë qytetarëve të drejtën për të përdorur lirshëm gjuhën ose alfabetin e tyre. Për më tepër, nëse shkelja kryhet nga një person zyrtar, parashikohet një dënim më i ashpër me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Megjithatë, pavarësisht këtyre dispozitave, reagimi institucional ndaj shkeljeve të ligjit është i pamjaftueshëm ose mungon tërësisht. Nuk inicohen procedura të duhura ndaj personave përgjegjës, dhe as nuk sigurohet mbrojtje efektive për të drejtat e qytetarëve të prekur. Një qasje e tillë selektive dhe arbitrare ndaj aplikimit të ligjit tregon ose mungesë të vullnetit politik për të zbatuar ligjet ekzistuese, ose synim për të ruajtur status quo-në ku shpërfillen normat ligjore dhe detyrimet ndërkombëtare. Kjo situatë kontribuon më tej në zbehjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe minon parimet themelore të sundimit të ligjit.

¹⁵ https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/ZAKONIK_BR_06_L-074O_KRIVICNOM_ZAKONIKU_REPUBLIKE_KOSOVO.pdf

ZYRA E KOMISIONERIT PËR GJUHËT

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (Office of the Language Commissioner – OLC) u themelua në bazë të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve,¹⁶ i adoptuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2006. Ky ligj garanton përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare – shqipes dhe serbishtes. Zyra e Komisionerit për Gjuhët filloi punën në vitin 2012, si institucion i pavarur përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Në Kosovë, Zyra u themelua si organ i pavarur brenda Institucionit të Avokatit të Popullit, me mandatin për të kryer mbikëqyrjen e zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve gjuhësore. Roli i saj kryesor është të sigurojë që të gjitha institucionet publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, përmbushin detyrimet e tyre lidhur me komunikimin dygjuhësh ose shumëgjuhësh, si dhe të promovojnë barazinë dhe përfshirjen gjuhësore. Ndër kompetencat kryesore të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët përfshihet monitorimi i aplikimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe identifikimi i parregullsive në aplikimin e tij. Zyra vepron në bazë të ankesave të qytetarëve dhe institucioneve lidhur me shkeljet e të drejtave gjuhësore dhe jep rekomandime për organet kompetente për të përmirësuar politikën gjuhësore. Për më tepër, ajo informon rregullisht publikun dhe i raporton Kuvendit mbi gjendjen e të drejtave gjuhësore dhe masat e ndërmarra, ndërsa një pjesë e rëndësishme e punës së saj është edhe promovimi i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e barazisë gjuhësore në jetën publike. Qytetarëve të Kosovës kanë në dispozicion disa mekanizma institucionalë për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Shkeljet e Ligjit për përdorimin e gjuhëve mund të raportohen drejtpërdrejt në Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, e cila është kompetente për shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve dhe dhënien e rekomandimeve për institucionet. Përveç kësaj, qytetarët mund t'i drejtohen Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet e diskriminimit ose mohimit të të drejtave themelore, si dhe të nisin procedura pranë gjykatave dhe prokurorive në raste më të rënda. Ankesat mund të adresohen gjithashtu te ministritë përkatëse dhe administratat komunale, të cilat janë të detyruara të veprojnë në përputhje me detyrimet ligjore dhe rekomandimet e Komisionerit. Megjithatë, sipas Analizës së Trendeve të vitit 2024,¹⁷ të kryer nga OJQ Aktiv, është evidentuar rënie e besimit të komunitetit serb në institucionet e Kosovës. Në punën e saj të mëparshme, zyra ka luajtur rol të rëndësishëm në dokumentimin¹⁸ dhe nxjerrjen në pah të rasteve të shkeljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve, dhe raportet e rekomandimet e saj shpesh kanë shërbyer si bazë për mbikëqyrje qytetare dhe avokim nga shoqëria civile. Megjithatë, që nga viti 2025, kjo zyrë nuk ka komisioner të emëruar,¹⁹ gjë që ka krijuar një vakum serioz institucional. Edhe pse zyra formalisht vazhdon të funksionojë, mungesa e një figure udhëheqëse ndikon drejtpërdrejt në kapacitetin e saj për të reaguar në mënyrë aktive ndaj shkeljeve të ligjit, për të nxjerrë rekomandime detyruese dhe për të ushtruar mbikëqyrje sistematike ndaj punës së institucioneve. Mandati i Komisionerit për Gjuhët në Kosovë ka skaduar dhe ende nuk është emëruar një komisioner i ri, gjë që ka krijuar vakum institucional. Njëkohësisht, Zyra për Çështje të Komuniteteve është jofunksionale për më shumë se një vit, pasi emërimi i udhëheqësit të saj është shtyrë për një kohë të gjatë. Kjo zyrë është përballur gjithashtu me sfida të shumta lidhur me transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e programeve të saj. Një hulumtim i kryer nga BIRN zbuloi se ishin ndarë fonde për organizata që nuk kishin asnjë lidhje me komunitetet pakicë, gjë nxiti kritika të gjera dhe çoi në një hetim nga Prokuroria Themelore e Prishtinës. Mungesa e komisionerit dërgon një mesazh të fuqishëm për mungesën e vullnetit politik për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore dhe dobëson më tej besimin e komuniteteve jo-shumicë në kornizën institucionale që supozohet t'u garantojë barazinë.

¹⁶ https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ZAKON_BR_02_L-37_O_UPOTREBI_JEZIKA1346.pdf

¹⁷ <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2025/04/Analiza-Trendova-2024-1.pdf>

¹⁸ <https://drive.google.com/file/d/1jX1LrnVD9r89fs-B81TDuPhCXyIDUaT3/view>

¹⁹ <https://docs.un.org/en/S/2025/200?utm>

Pa një mekanizëm mbikëqyrës funksional dhe legjitim, shkeljet e ligjit shpesh nuk raportohen dhe rrjedhimisht mbeten të pandëshkuara, ndërsa diskriminimi gjuhësor normalizohet në praktikën institucionale. Në përputhje me Rregulloren nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët,²⁰ është e nevojshme të emërohet një komisioner i ri sa më shpejt të jetë e mundur, meqenëse mandati i komisionerit të tanishëm ka skaduar, në mënyrë që të rivendosen kapacitetet institucionale për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore dhe të sigurohen zbatimi efektiv të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

²⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8364>

ARSIMI
DHE POLITIKA
GJUHËSORE

SISTEMI ARSIMOR DHE DYGJUHËSIA

Gati një çerek shekulli pas përfundimit të luftës, çështja e mësimi institucional të gjuhëve zyrtare në Kosovë mbetet e pazgjidhur. Edhe pse si gjuha shqipe ashtu edhe ajo serbe njihen me Kushtetutë si gjuhë zyrtare, sistemet arsimore funksionojnë paralelisht, njëri brenda sistemit serb, tjetri brenda sistemit kosovar, pa asnjë pikëtakim të ndërsjellë. Në një mjedis të tillë, mësimi i gjuhës shqipe nuk është pjesë e planeve dhe programeve mësimore në shkollat që veprojnë sipas sistemit arsimor serb, ndërsa gjuha serbe nuk studiohet në shkollat brenda sistemit të Kosovës. Kjo situatë nuk është vetëm pasojë e izolimit pas luftës, por ka rrënjë më të thella në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe ndryshimet e politikave arsimore në vitet 1990, kur u suprimua dygjuhësia institucionale në shkolla. Me këtë u ndërpre edhe lidhja e fundit institucionale e gjuhëve jo-amtare me trashëgiminë e ish-Jugosllavisë, ku përmes mësimi të gjuhëve të “të tjerëve” synohej tkurja e ndasive etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Pavarësisht turbulencave shoqërore e politike të asaj kohe, ky model nënkuptonte një përgjegjësi institucionale për ndërtimin e një shoqërie shumetnike në Kosovë. Një ndarje e tillë pamundëson zhvillimin e një shoqërie funksionale dygjuhëshe dhe përjetëson segregimin e komuniteteve. Megjithatë ekziston Ligji për përdorimin e gjuhëve, aplikimi i tij nuk reflektohet në praktikën arsimore, duke reduktuar ndjeshëm mundësitë për komunikim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis të rinjve. Kësisoj, brezat e rinj që dalin, po largohen nga standardet e brezave më të vjetër, ndër të cilët njohja e të dyja gjuhëve ishte dukuri shumë më e përhapur dhe e pranuar shoqërisht.

Analizat e aktorëve ndërkombëtarë dhe të brendshëm tregojnë se mësimi i gjuhëve në kuadër të sistemit shkollor është mënyra më efikase dhe më e qasshme për të siguruar përvetësimin masiv të kompetencave gjuhësore. Kurset private dhe mësimet individuale mbeten me shtrirje të kufizuar dhe financiarisht të papërballueshme për një pjesë të madhe të qytetarëve, ndërsa futja institucionale e gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe në shkolla do të mundësonte qasje të gjerë dhe do të siguronte barazi në arsim.

Duke pasur parasysh standardet evropiane dhe detyrimet që dalin nga procesi i integritimeve evropiane, është e qartë se sistemi arsimor i Kosovës duhet të ndërmarrë zgjidhje strukturore që synojnë promovimin e shumëgjuhësisë. Një nga opsionet realiste është futja e gjuhës shqipe në shkollat serbe dhe e gjuhës serbe në shkollat shqipe si lëndë zgjedhore. Në këtë mënyrë do të ruhej liria e zgjedhjes për nxënësit dhe prindërit, ndërsa njëkohësisht do të sigurohej prania institucionale e të dyja gjuhëve zyrtare në arsim. Parakusht për institucionalizimin e mësimi të të dyja gjuhëve mund të arrihet përmes futjes së lëndëve zgjedhore të gjuhës serbe dhe gjuhës shqipe në shkolla, ndërsa kjo çështje do të duhej të shtrohet në kuadër të procesit teknik të negociatave në Bruksel. Kjo do të hapte mundësinë e ruajtjes së dygjuhësisë, por gjithashtu do të hidhte themelet për marrëdhëniet e ardhshme midis serbëve dhe shqiptarëve mbi bazën e marrëveshjeve të ndërsjella, e jo mbi bazën e zgjidhjeve të imponuara. Një qasje e tillë nënkupton përgjegjësi të plotë politike të bartësve të pushtetit, të cilët, pas dekadash politikash të papërgjegjshme, më në fund do të duhet të tregojnë guxim politik dhe gatishmëri për të marrë përgjegjësi ndaj brezave të ardhshëm, në përpjekje për të ruajtur një Kosovë shumetnike dhe shumëgjuhëshe.

Politika e tillë do të kontribuonte në forcimin e integritit të ndërsjellë, rritjen e kohezionit shoqëror dhe krijimin e parakushteve afatgjata për stabilitet. Për më tepër, rikthimi i praktikës nga periudha para konfliktit, kur të dyja gjuhët ishin të pranishme në planet dhe programet mësimore, jo vetëm që do të përmbushte standardet ndërkombëtare, por do të ishte edhe një hap i rëndësishëm në ndërtimin e besimit dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve.

ALBANOLOGJIA NË BEOGRAD DHE BALLKANISTIKA NË PRISHTINË

Programi i studimit i Ballkanistikës në Prishtinë dhe i Albanologjisë në Beograd për një kohë të caktuar mund të perceptoheshin si ura akademike dhe gjuhësore ndërmjet dy popujve. Ballkanistika ishte një program studimi katërvjeçar, i cili u hap²¹ në vitin 2021 në kuadër të Universitetit të Prishtinës me qëllim, ndër të tjera, promovimin e komunikimit ndërgjuhësor dhe ndërkulturor në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përveç gjuhës shqipe, studentët kishin mundësi të mësojnë edhe gjuhë të tjera ballkanike, si serbisht, boshnjakisht, kroatisht apo maqedonisht. Megjithatë, sipas deklaratës së prof. dr. Seniha Krasniqit, udhëheqëse e programit të Ballkanistikës në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, deklaratë e cila u dha për nevojat e këtij raporti, këtë vit nuk është shpallur konkurs për regjistrim në programin e Ballkanistikës, pasi ai nuk është akredituar tashmë për dy vite me radhë.

Një nga sfidat kryesore në ruajtjen dhe zhvillimin e programeve të studimit në fushën e gjuhëve dhe letërsive ballkanike në Universitetin e Prishtinës është mungesa e kuadrit të nevojshëm për mësimdhënie. Sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, angazhimi i profesorëve dhe mësimdhënësve të rregullt përbën kriterin bazë për miratimin dhe akreditimin e programeve të studimit. Në praktikë, vështirësitë në gjetjen e stafit akademik të kualifikuar pengojnë stabilitetin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e këtyre programeve të studimit. Aktualisht, programi zhvillohet në vitin e tretë dhe të katërt, ndërsa një pjesë e studentëve tashmë janë të punësuar në organizata dhe agjenci përkthimi, gjë që dëshmon vlerën praktike dhe aplikueshmërinë e njohurive të fituara gjatë studimeve. Megjithatë, nuk ka të dhëna të qarta mbi numrin e përgjithshëm të studentëve aktivë, as mbi planet e Universitetit të Prishtinës për të vazhduar me zhvillimin dhe avancimin e programit të Ballkanistikës në të ardhmen.

Ndërkohë, Katedra e Albanologjisë në Fakultetin e Filologjisë në Beograd funksionon tashmë prej më shumë se një shekulli. Sipas të dhënave për vitin akademik 2025-2026,²² në kryeqytetin e Serbisë, programi Gjuha, letërsia dhe kultura shqipe pranon 14 studentë, dhjetë me financim nga buxheti dhe katër studentë me vetëfinancim.

²¹ <https://filologjia.uni-pr.edu/page.aspx?id=2,51>

²² https://fil.bg.ac.rs/uploads/files/upis/2025/Upisne_kvota_JKK_2025-2026.pdf

MUNDËSITË PËR TË MËSUAR GJUHËT NË MËNYRË TË PAVARUR

Problemi shumëvjeçar institucional i njohjes së pamjaftueshme të gjuhës shqipe në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb, dhe anasjelltas, është veçanërisht i theksuar te popullata e re. Hendeku ekzistues në mësimin e gjuhëve, i krijuar nga shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, u thellua më tej pas konfliktit në Kosovë. Pavarësisht kërkesave të shumta, fillimisht nga organizatat joqeveritare, e pjesërisht edhe nga bashkësia ndërkombëtare, nuk është bërë ndonjë hap i qenësishëm në nivel institucional për adresimin e këtij problemi. Për ta tejkaluar qoftë edhe pjesërisht këtë mungesë, organizatat jo-qeveritare me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë kanë organizuar kurse të ndryshme, kryesisht mbi baza vullnetare. Megjithatë në fillim këto iniciativa ngjallën njëfarë interesi, burimet e kufizuara, motivimi i ulët i pjesëmarrësve, si dhe mungesa e kohës për të mësuar në mënyrë të vazhdueshme gjuhën, bënë që ndikimi i tyre të mbetej i kufizuar dhe të përfshinte vetëm një numër të vogël qytetarësh, kryesisht adoleshentë dhe persona të moshës së mesme.

Me zgjerimin e teknologjive digjitale, rritjen e qasjes në internet dhe shtimin e përdoruesve të rrjeteve sociale, u krijua mundësia për qasje më të gjerë dhe më novatore. Kështu, në vitin 2018, u prezantua platforma online Vokap (Vocup),²³ për mësimin e gjuhës serbe dhe gjuhës shqipe, e cila u zhvilluar nga Qendra për Iniciativa Sociale. Projekti u mbështet nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, IOM, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët. Platforma ofron mësim me video, shpjegime tekstuale, ushtrime praktike dhe një fjalor termash të rinj; ajo është e qasshme si përmes uebsajtit, ashtu edhe përmes aplikacioneve Android dhe iOS. Ky zhvillim paraqet një hap përpara drejt krijimit të mundësive më të qasshme dhe më praktike për të mësuar gjuhët, megjithatë mbetet vetëm një zëvendësim i përkohshëm për mungesën e një zgjidhjeje institucionale.

Megjithatë, iniciativat pozitive të organizatave me përgjegjësi shoqërore nuk janë shoqëruar me mbështetje të përshtatshme institucionale. Për pasojë, këto dhe përpjekje të ngjashme, duke u mbështetur pothuajse tërësisht në ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, kanë mbetur përpjekje afatshkurtra dhe fragmentare për të ndryshuar gjendjen e pafavorshme. Mungesa e mbështetjes institucionale pikas më tej mungesën e vullnetit politik që çështja e mësimin të gjuhëve dhe e të drejtave gjuhësore të zgjidhet në mënyrë të qëndrueshme dhe sistematike.

²³ <https://www.voc-up.com/>

MODELET DHE PRAKTIKA KRAHASUESE

PASQYRË KRAHASUESE: GJUHËT ZYRTARE NË TË DREJTËN KRAHASUESE

Në shumë vende të botës zyrtarisht njihen dhe përdoren dy ose më shumë gjuhë në legjislacion, administratë, arsim etj. Për sa i përket Evropës, shumëgjuhësia zyrtare është e pranishme edhe në: Zvicër (katër gjuhë): gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja dhe retoromanishtja; Belgjikë (tri gjuhë): holandishtja/flamandishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja; Finlandë (dy gjuhë): finlandishtja dhe suedishtja; Irlandë (dy gjuhë): irlandishtja (gjuha galike) dhe anglishtja; Luksemburg (tri gjuhë): luksemburgishtja, gjermanishtja dhe frëngjishtja; Bosnjë dhe Hercegovinë (tri gjuhë): boshnjakishtja, serbishtja dhe kroatishtja. Edhe Mali i Zi njih disa gjuhë – përveç gjuhës malazeze, aty njihen zyrtarisht edhe serbishtja, boshnjakishtja, shqipja dhe kroatishtja.

Zvicra shquhet si shembull i suksesshëm i shumëgjuhësisë institucionale, të ndërtuar mbi federalizëm dhe autonomi rajonale. Katër gjuhë – gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja dhe retoromanishtja – gëzojnë status zyrtar, ndërsa kantonet vendosin vetë për gjuhën e arsimit dhe administratës. Në sistemin arsimor është e detyrueshme të mësohet të paktën njëra nga gjuhët e tjera kombëtare, duke siguruar kështu komunikim ndërmjet komuniteteve dhe zbutje të barrierave gjuhësore. Çelësi i suksesit qëndron në respektimin e parimit territorial dhe në shkallën e lartë të tolerancës, ku shteti nuk imponon një gjuhë dominuese, por nxit diversitetin kulturor dhe gjuhësor.

Belgjika, nga ana tjetër, është shembull i shumëgjuhësisë së ndarë, e cila shpesh shoqërohet me tensione të theksuara mes komuniteteve gjuhësore. Tri gjuhë zyrtare – flamanishtja (holandishtja), frëngjishtja dhe gjermanishtja – njihen në nivel rajonal, ndërsa Brukseli është dygjuhësh nga aspekti institucional. Secila bashkësi gëzon politikat e veta arsimore dhe kulturore, gjë që tregon se decentralizimi mund të mundësojë ruajtjen e të drejtave gjuhësore, por njëkohësisht nxjerr në pah se si mungesa e mekanizmave integruarë mund të thellojë ndasitë. Mu nga ky shembull, Kosova mund të nxjerrë mësim mbi nevojën që dygjuhësia të mos mbetet vetëm e ndarë nga aspekti territorial, por të institucionalizohet edhe përmes sistemit arsimor si hapësirë e përbashkët.

Bosnja e Hercegovina thekson më tej sfidat që paraqiten kur disa gjuhë bashkekzistojnë formalisht brenda një sistemi arsimor. Prania e gjuhës boshnjake, gjuhës serbe dhe gjuhës kroate çoi në paralelizëm në arsim, shpesh të shoqëruar me dukurinë e segregimit (“dy shkolla nën një çati”). Ky shembull tregon se njohja formale e gjuhëve nuk është e mjaftueshme nëse mungon vullneti politik dhe strategjia pedagogjike për ndërtimin e programeve të integruara.

Krahasuar me këto modele, Kosova mund të zhvillojë një sistem që kombinon parimin territorial (ngjashëm me modelin zviceran) me elementet e detyrueshme të mësimi të përbashkët të të dyja gjuhëve zyrtare në arsim (ngjashëm me modelin finlandez). Një qasje e tillë do të mundësonte që brezat e rinj të zhvillojnë njohuri funksionale si të gjuhës shqipe, ashtu edhe të gjuhës serbe, duke kontribuar në kohezionin shoqëror dhe respektimin e standardeve evropiane në fushën e të drejtave të pakicave.

PRAKTIKA INSTITUCIONALE DHE MONITORIMI

Mungesa e aplikimit të qëndrueshëm institucional të gjuhës serbe në Kosovë përbën një problem shumëvjeçar dhe sistemor. Edhe pse serbishtja, së bashku me shqipen, njihet me Kushtetutë si gjuhë zyrtare, praktika tregon se institucionet në masë të madhe e shpërfillin këtë detyrim. Qytetarët që flasin gjuhën serbe shpesh mbeten pa qasje të barabartë në informacionin bazë – që nga proceset e zgjedhjeve dhe ligjet, deri te udhëzimet administrative, konkurset për punësim, shpalljet publike dhe programet e subvencioneve. Gjatë viteve të shkuara është zbatuar një numër i konsiderueshëm projektesh, kryesisht të financuara nga bashkësia ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e praktikës së respektimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Megjithatë, ndikimi i këtyre iniciativave ka mbetur i kufizuar, ndërsa problemet thelbësore vazhdojnë të ekzistojnë. Shkaqet e kësaj gjendjeje janë të shumtë – duke filluar nga mungesa e përkthyesve të kualifikuar dhe kapacitetet e dobëta administrative, e deri te faktori më i rëndësishëm: mungesa e vullnetit politik për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë sistematike dhe të përgjegjshme. Në vend të kësaj, gjithnjë e më shpesh jemi dëshmitarë të përpjekjeve për t'i paraqitur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje si privilegje, gjë që krijon një klimë ku aplikimi selektiv i ligjit bëhet i pranueshëm shoqërisht. Pasojat e kësaj praktike janë të shumëfishta. Qytetarëve të komuniteteve jo-shumicë u vështirësohet ose u pamundësohet qasja në informacione që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat dhe detyrimet e tyre: votuesit nuk njoftohen me kohë në gjuhën e tyre për procedurat e zgjedhjeve, bujqit nuk kanë qasje të barabartë në konkurset për subvencione, ndërsa shumë qytetarë mbesin pa mundësinë për t'u paraqitur në konkurse publike për shkak të mungesës së përkthimeve. Këta shembuj tregojnë qartë se mosrespektimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve ka pasoja të drejtpërdrejta dhe serioze për cilësinë e jetës dhe barazinë e qytetarëve.

Duke u nisur nga këto rrethana, monitorimi ynë ka përfshirë 10 institucione kyç në Kosovë, duke filluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili në atë kohë ishte në fokus për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Analiza ka shpërfaqur një sërë parregullsish në aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve – që nga fushatat e dedikuara për komunitetet jo-shumicë, deri te dallimet e dukshme ndërmjet përmbajtjeve në gjuhën shqipe dhe atë serbe në platformat zyrtare. Modele të ngjashme dolën në pah edhe te institucionet e tjera, ndërsa Gjykata Kushtetuese u veçua si një shembull pjesërisht pozitiv i përputhshmërisë, ndërsa organizatat e shoqërisë civile si ilustrim se dygjuhësia cilësore mund të arrihet edhe me burime dukshëm më modeste. Kjo vërteton se problemi kryesor nuk qëndron te mungesa e mjeteve financiare, por te mungesa e përgjegjësisë politike dhe gatishmërisë së institucioneve për të aplikuar ligjin në mënyrë konsistente.

GJETJET E DETAJUARA TË MONITORIMIT TREMUJOR: PASQYRË SIPAS INSTITUCIONIT

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

BUXHETI: 8,7 MILIONË EURO

NUMRI I PUNONJËSVE: NUK KA TË DHËNA

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR:

NUK KA TË DHËNA

Monitorimi i uebsajtit zyrtar dhe pranisë në media sociale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Kosovës, ka treguar një varg lëshimesh serioze në lidhje me respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Edhe pse, si institucion kyç për zgjedhjet, KQZ do të duhej të siguronte qasje të barabartë në informacion për të gjithë qytetarët, analiza vuri në dukje shpërfilljen sistemore të gjuhës serbe dhe forma të dukshme të diskriminimit institucional ndaj komuniteteve jo-shumicë. Në uebsajtin e KQZ-së në gjuhën serbe janë vërejtur shumë vegëza (links) jofunksionale, që drejtpërdrejt pamundësojnë qasjen në dokumente dhe informacione të rëndësishme. Cilësia e përmbajtjes është jashtëzakonisht e dobët – tekstet shpesh janë plot e përplot me gabime drejtshkrimore, ndërsa përkthimet shpesh janë aq të dobëta sa që e bëjnë të vështirë kuptimin e informacionit bazë. Për sa i përket transparencës dhe strukturës institucionale, versioni i uebsajtit në shqip rendit 11 anëtarë të KQZ-së, ndërsa versioni në serbisht shfaq vetëm pesë, gjë që ilustron qartë mungesën e konsistencës në paraqitjen e të dhënave bazë.

Përveç kësaj, elementet e prezantimit vizual dhe përmbajtjesor – siç janë organogrami, udhëzimet për votim, statistikat e zgjedhjeve dhe rregulloret e brendshme – nuk janë përkthyer fare në serbisht, d.m.th., ato janë të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe. Veçanërisht problematike është mungesa e informacionit në gjuhën serbe në seksionin për media, ku nuk ka udhëzime për akreditimin e gazetarëve dhe vëzhguesve, duke i vënë kështu gazetarët nga komunitetet jo-shumicë në pozitë të pabarabartë.

Seksione të tilla si planet operative të zgjedhjeve, shpalljet për punësim, mbledhjet dhe vendimet e KQZ-së, në shumicën dërrmuese të rasteve janë të qasshme vetëm në gjuhën shqipe. Konkursët dhe aplikimet për punësim, si dhe arkivi i konkurseve të mëparshme, publikohen ekskluzivisht në gjuhën shqipe, madje edhe në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe. Tregues shtesë i mangësive është fakti që raporti i fundit vjetor në gjuhën serbe daton nga viti 2016, ndërsa në gjuhën shqipe i njëjti dokument është publikuar deri në vitin 2022.

Modele identike janë vërejtur edhe në llogaritë zyrtare të KQZ-së në rrjetet sociale. Në faqen në Facebook, postimet më së shpeshti shfaqen së pari në shqip, pastaj në anglisht, ndërsa gjuha serbe rregullisht lihet pas dore ose mungon plotësisht. Në Instagram, disa informacione publikohen vetëm në shqip dhe anglisht, pa asnjë përkthim në serbisht. Në rrjetin X (ish-Twitter), materialet video të fushatës informuese janë publikuar vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa tekstet shoqëruese janë në anglisht, pa asnjë përmbajtje në gjuhën serbe.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

BUXHETI: 216 MILIONË EURO

NUMRI I PUNONJËSVE: 944

(49 NGA KOMUNITETET JO-SHUMICË)

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: 1

Analiza e uebsajtit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës (MPB), si dhe e pranisë së saj në rrjetet sociale, ka evidentuar një sërë parregullsish që nxjerrin në pah shpërfilljen sistimore të gjuhës serbe dhe mosrespektimin e detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji për përdorimin e gjuhëve.

Versioni në gjuhën serbe i uebsajtit të MPB-së është dukshëm më i varfër në përmbajtje dhe teknikisht më pak i mirëmbajtur në krahasim me versionin në shqip. Disa faqe, dokumente dhe funksionalitete, përfshirë aplikimin online për patentë-shofer, nuk janë të qasshme në gjuhën serbe ose janë të papërdorshme. Shumë përmbajtje janë të disponueshme vetëm në shqip, ose në shqip dhe anglisht, ndërsa përkthimet në serbisht përmbajnë gabime të rënda gramatikore dhe terminologjike, shpesh deri në masën që e bëjnë tekstin të pakuptueshëm. Institucione të caktuara brenda MPB-së, si Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia për Siguri Kibernetike, nuk janë të qasshme fare në gjuhën serbe – njëra ekziston vetëm si faqe në Facebook me postime në shqip dhe rrallë në anglisht, ndërsa linku i ofruar për tjetrën nuk është funksional. Në segmentin e sigurisë civile, faqja “Siguria e Aviacionit Civil” nuk ekziston fare në serbisht. Struktura e uebsajtit është shpesh e paorganizuar dhe jologjike – renditja e gjuhëve në navigim favorizon shqipen dhe anglishten, ndërsa serbishtja vendoset në plan të tretë, pavarësisht se anglishtja nuk ka status zyrtar në Kosovë. Disa video materiale në galeri, si dhe postime të tjera multimediale, nuk janë të titruara e as të dubluara në serbisht.

Probleme të tjera teknike dhe përmbajtjesore janë vërejtur në seksionin “Lajme”, ku shfaqen karaktere diakritike tipike të shqipes, gjë që tregon se ka gabime në futjen e tekstit. Rubrika si “Siguria e Aviacionit Civil”, “Taksat Ekologjike” dhe “Kriteret për t’u pajisur me lejeqëndrim” janë të disponueshme vetëm në shqip. Në seksionin “Vendimet e Ministrit”, ashtu si edhe në dokumentet strategjike dhe planet kombëtare, përmbajtja është e disponueshme vetëm në shqip, ndërsa në përkthime shfaqen gabime të rënda gjuhësore. Një shembull i qartë është shprehja: “Prema Zakonu br. 08 / L – 197 za službenike u izdavaštvo”, e cila dëshmon se është bërë përkthim automatik dhe pa kuptim.

Një problem i veçantë lidhet me përmbajtjen e letërnjoftimit që lëshohet nga MPB. Në versionin e gjuhës serbe përdoret termi “Kosovar”, ndonëse forma e saktë gjuhësore është “Kosovac”. Ky përdorim nuk është vetëm i pasaktë gjuhësisht, por mund të perceptohet edhe si fyes në aspektin kulturor.

Dominimi i gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze është vërejtur edhe në rrjetet sociale. Në faqen zyrtare të Ministrisë në Facebook, pothuajse të gjitha postimet, përfshirë materialet video, janë vetëm në shqip, pa përkthim apo titrim në serbisht. Emri i ministrisë paraqitet gjithashtu vetëm në shqip. Në X (ish-Twitter), emri i ministrisë është në anglisht, ndërsa përmbajtja është kryesisht në anglisht dhe shqip, me përdorim pothuajse të papërfillshëm të serbishtes.

Si pjesë e monitorimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme iu dërguar një email zyrtar me pyetje, ndaj të cilit është kthyer përgjigje fillimisht në shqip, e më pas në serbisht. Në përgjigje thuhet se aktualisht në MPB janë të punësuar gjithsej 944 nëpunës, prej të cilëve 49 janë nga komunitetet jo-shumicë, përfshirë 33 nga komuniteti serb, 9 nga komuniteti turk, 3 nga komuniteti boshnjak, 2 nga komuniteti egjiptian, dhe nga një pjesëtar i komunitetit goran dhe ashkali. Në këtë institucion është i punësuar vetëm një nëpunës me vendim zyrtar për pozitën e përkthyesit për shqip-serbisht/serbisht-shqip, i cili është përgjegjës për përkthimin e të gjitha dokumenteve të Ministrisë.

Të dhënat e monitorimit tregojnë qartë se një person i vetëm nuk mund të përmbushë në mënyrë adekuate një vëllim kaq të madh pune, gjë që rezulton në cilësi të dobët të përmbajtjes në serbisht. Duke marrë parasysh se buxheti vjetor i kësaj ministrie arrin në 216 milionë euro, është e qartë se kanë ekzistuar kapacitetet financiare për të siguruar një përkthim adekuat në gjuhën serbe.

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

BUXHETI: 1.723.247,25 EURO

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: 82

(5 NGA KOMUNITETET JO-SHUMICË)

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: 0

**(KONTRATË AKTIVE ME NJË KOMPANI TË JASHTME QË
OFRON SHËRBIME PËRKTHIMI)**

Analiza e uebsajtit zyrtar të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) shpërfaq probleme të dukshme në drejtim të aplikimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, veçanërisht në raport me gjuhën serbe si një nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Një nga mangësitë e para të evidentuara është fakti se skema organizative e institucionit (organogrami), që paraqitet në pjesën e uebsajtit të dedikuar për komunitetin serb, është tërësisht në gjuhën shqipe, gjë që e vështirëson ose e bën të pamundur për përdoruesit e gjuhës serbe kuptimin e strukturës dhe funksioneve të institucionit.

Gjithashtu, emri i institucionit në uebsajt nuk është në përputhje me të drejtat gjuhësore zyrtare, pasi gjuha serbe shfaqet vetëm në vend të tretë, pas shqipes dhe anglishtes, megjithëse anglishtja nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë.

Seksioni i lajmeve tregon se shumë përmbajtje në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe janë të shkruara vetëm në shqip, ndërsa në disa raste, përveç titullit, nuk jepet asnjë informacion tjetër.

Përkthimi në kategorinë “Departamentet” është i pakuptueshëm, me fraza jologjike dhe konfuze, ndërsa herë pas here përdoret edhe varianti “ijekavica”. Për më tepër, vegëzat që çojnë te dokumentet kryesore, siç janë ligjet dhe udhëzimet administrative, nuk funksionojnë në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe, ndërsa në gjuhën shqipe janë të gjitha në rregull.

Në segmentin e raporteve, në versionin në gjuhën serbe janë të disponueshme vetëm raportet nga viti 2022 e tutje, ndërsa raportet për periudhën 2006–2021 mungojnë plotësisht. Të gjitha raportet financiare të qasshme në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe janë të publikuara në gjuhën shqipe, ndërsa tentativat për shkarkim shfaqin mesazh se ka ndodhur gabim teknik (“Server Error”). Tutje, revista periodike “Integriteti” të cilën e boton IPK-ja, nga gjithsej 14 numra, vetëm në dy raste është e disponueshme në gjuhën serbe.

Krahas uebsajtit, analiza e pranisë së Inspektoratit Policor në rrjete sociale tregon dominim të gjuhës shqipe, ndërsa gjuha serbe trajtohet si marginale. Në profilin e institucionit në Facebook, emri dhe informacionet bazë paraqiten vetëm në shqip, ndërsa përmbajtjet në gjuhën serbe publikohen pas shqipes dhe anglishtes, megjithëse anglishtja nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë. Materialet video pothuajse asnjëherë nuk janë të titruara apo të dubluara në gjuhën serbe. Situatë e ngjashme vërehet edhe në platformën X (ish-Twitter), ku që nga viti 2019 e deri më sot të gjitha përmbajtjet janë të publikuara vetëm në shqip. Në kanalin e IPK-së në YouTube janë publikuar gjithsej pesë video, prej të cilave vetëm një është në gjuhën serbe, ndërsa të tjerat janë në shqip dhe anglisht.

Në kuadër të monitorimit, me pyetje shtesë jemi drejtuar tek Inspektorati Policor i Kosovës dhe kemi marrë këtë përgjigje: IPK ka gjithsej 82 zyrtarë, prej të cilëve pesë zyrtarë të stafit operativ janë nga komunitetet jo-shumicë, përfshirë tre hetues nga komuniteti serb dhe dy nga komuniteti boshnjak. Është me rëndësi të theksohet se IPK nuk ka të punësuar përkthyes për gjuhën serbe, por ka kontratë aktive me një kompani të jashtme që ofron shërbime përkthimi në gjuhën serbe.

POLICIA E KOSOVËS

BUXHETI: 159.736.292,89 EURO

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: NUK KA TË DHËNA

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR:

NUK KA TË DHËNA

Analiza e uebsajtit zyrtar të Policisë së Kosovës tregon mangësi të mëdha në aspektin e aplikimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, veçanërisht në raport me gjuhën serbe. Pjesa e uebsajtit e dedikuar për përdoruesit e gjuhës serbe përmban tekste që në shumicën e rasteve janë vetëm në shqip, duke përfshirë edhe kategoritë dhe përmbajtjet themelore. Përveç kësaj, janë evidentuar shembuj të shumtë të përkthimeve të dobëta, të pakuptueshme dhe gramatikisht të pasakta, si dhe gabime të shpeshta drejtshkrimore. Shembuj të tillë janë shprehjet si “Prijaviti zločin” ose “Departamenti”, por edhe tekste më të ndërlikuara në kategorinë e lajmeve, ku përkthimet jo vetëm që janë të cilësisë së pamjaftueshme, por shpesh shkaktojnë huti, kanë ndërtim të parregullt të fjalive dhe përdorim të shpeshtë të variantit “ijekavica”. Një pjesë e madhe e lajmeve në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe paraqitet në gjuhën shqipe, edhe pse në uebsajt ekziston një seksion i veçantë për publikimin e informacionit në shqip.

Kategoritë që lidhen me njësitë e specializuara, si “Departamenti i Njësive Speciale” dhe “Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës”, nuk janë të disponueshme në serbisht ose shfaqin vetëm tituj pa përmbajtje. Problem i ngjashëm vërehet edhe në kategoritë si “Departamenti i Kufirit” dhe “Departamenti i Hetimeve”, ku emërtimet dhe tekstet janë kryesisht në shqip, ndërsa në serbisht paraqiten me gabime të shumta gjuhësore dhe drejtshkrimore. Një shembull tjetër është “Departamenti i Burimeve Njerëzore”, i cili në serbisht është përkthyer gabimisht si “Uprava za ljudske izvore”, pa përdorur termin standard “Odeljenje za ljudske resurse”. Po ashtu, në kategorinë “Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse” shfaqet vetëm titulli, pa asnjë tekst shoqërues.

Në nivel rajonal, emrat e qyteteve dhe rajoneve shpesh janë të shënuar vetëm në shqip ose shfaqen përkthime të pasakta në serbisht, ndërsa në disa raste përdoret edhe gjuha angleze. Tutje, segmenti i dedikuar për sigurinë e komuniteteve në gjuhën serbe përmban shumë gabime, duke krijuar paqartësi në komunikimin e informacionit kyç. Në kategorinë “Projekte, Vetëdijesim, Aktivitete”, të gjithë titujt e dokumenteve janë vetëm në shqip, ndërsa disa nga dokumentet e fushatave informuese ekzistojnë edhe në serbisht, por përkthimet janë shpesh të pakuptueshme. Është vërejtur edhe një disproporcion i madh ndërmjet numrit të dokumenteve të disponueshme në shqip dhe në serbisht, sidomos në kategoritë që lidhen me aktet policore, udhëzimet administrative, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëveshjet me institucionet lokale. Për shembull, në kategorinë e akteve policore janë të publikuara 45 dokumente në shqip, ndërsa në serbisht më pak se gjysma e këtij numri.

Një qasje e ngjashme shihet edhe në kategorinë “Mundësi Punësimi”, ku shumica e dokumenteve janë vetëm në shqip. Një shembull tjetër i qasjes joadekuate është seksioni “Kontakti”, ku gabimet drejtshkrimore dhe formulimet e dobëta të fjalive bien lehtësisht në sy, duke zbehur qartësinë dhe kredibilitetin e informacionit.

Po ashtu, për sa i përket raportimit të krimit, kategoria për raportimin e kriminalitetit kibernetik nuk është e qasshme në serbisht, ndërsa në seksionin “Personat në kërkim” në serbisht është i disponueshëm vetëm një urdhërarrest, kurse në shqip figurojnë madje 132.

Analiza e pranisë së Policisë së Kosovës në rrjetet sociale tregon gjithashtu dominim të gjuhës shqipe. Në profilin e institucionit në Facebook, emri i institucionit paraqitet në gjuhën angleze, ndërsa pothuajse të gjitha postimet dhe materialet video janë vetëm në shqip, me përjashtime të rralla që lidhen me ngjarjet në veri të Kosovës ose me konkurse për punësim. Situatë e ngjashme vërehet edhe në rrjetin X (ish-Twitter), ku emri dhe përmbajtja janë kryesisht në shqip dhe anglisht, pa përkthim në serbisht. Vetëm në kanalin e Policisë së Kosovës në YouTube ekziston një numër i kufizuar videosh dygjuhëshe, por pjesa më e madhe e materialeve është vetëm në shqip, pa tekste shoqëruese në serbisht.

Respektimi i të drejtave gjuhësore nga Policia e Kosovës është me rëndësi thelbësore për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi dhe siguri për të gjithë qytetarët, veçanërisht në veri të Kosovës, ku shumë qytetarë kanë shprehur shqetësim për faktin se shumica e policëve shqiptarë nuk flasin gjuhën serbe. Edhe pse Ligji për Policinë përcakton qartë detyrimin për komunikim në të dyja gjuhët zyrtare, në praktikë shpesh ndodh që qytetarët e komunitetit serb të hasin barriera gjuhësore gjatë raportimit të incidenteve, kërkimit të informacionit ose ushtrimit të të drejtave të tyre para institucioneve.

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL**

BUXHETI: 93.562.272 EURO

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: NUK KA

**NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: NUK KA TË
DHËNA**

Analiza e uebsajtit zyrtar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nxjerr në pah probleme serioze në aplikimin e gjuhëve zyrtare, veçanërisht në aspektin e qasjes dhe cilësisë së përmbajtjes në gjuhën serbe. Në versionin e uebsajtit në gjuhën serbe, emri i ministrisë figuron vetëm në gjuhën shqipe, dhe e njëjta gjë vlen edhe për informacionet e kontaktit në fund të faqes. Disa kategori të uebsajtit në gjuhën serbe paraqiten në gjuhën angleze, ndërsa në tërësi vërehet përdorim i pasaktë i shkronjave të mëdha dhe i shenjave diakritike karakteristike për gjuhën shqipe. Renditja e gjuhëve në menynë rënëse nuk respekton parimin e barazisë gjuhësore, pasi serbishtja gjendet në vendin e tretë, pas anglishtes, e cila nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë.

Në seksionin e raporteve dhe publikimeve, ndonëse ekziston pjesa e uebsajtit në serbisht, të gjithë titujt e raporteve paraqiten vetëm në shqip, ndërsa një pjesë e përmbajtjes nuk është e disponueshme ose mungon krejtësisht. Konkursat paraqesin një shembull më shumë të mosrespektimit të normave gjuhësore: në gjuhën shqipe janë të qasshme mbi 150 dokumente, ndërsa në gjuhën serbe vetëm tetë, prej të cilëve tre kanë titull në shqip. Mungesa e përmbajtjes është e dukshme edhe në kategorinë "Historiku dhe Mandati", ku në versionin në serbisht figuron vetëm titulli, pa asnjë tekst shpjegues.

Informacionet për sekretaren e përgjithshme në serbisht janë dukshëm të shkurtuara, pa fotografi dhe vetëm me të dhëna bazë, ndërsa në versionin shqip ofrohet biografia e plotë, kualifikimet dhe përvoja profesionale. Në seksionin e departamenteve dhe sektorëve, në versionin serbisht mungon kategoria për marrëdhëniet me publikun; gjithashtu, në njësinë për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi paraqiten vetëm informacione bazë për kontaktim; përkundrazi, versioni shqip është shumë më i detajuar dhe përfshin kornizën ligjore dhe mandatin.

Organogrami në versionin serbisht ekziston, por është me cilësi të ulët dhe rezolucion të vogël, gjë që e bën të vështirë leximin, ndërsa në shqip është i qartë. Mungesa e informacionit është e theksuar sidomos për zëvendësministrat: kjo kategori në serbisht është krejtësisht bosh ose përmban të dhëna të pandërlidhura, ndërsa në shqip paraqiten në detaje zëvendësministrat, asistentët dhe këshilltarët.

Edhe kategoria "Agjencitë" është një shembull i shkeljes së të drejtave për informim në gjuhën serbe: aty mungojnë krejtësisht informatat për Agjencinë e Pyjeve të Kosovës dhe Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, si dhe për pagesat direkte dhe projektet e zhvillimit rural. Në seksionin "Departamentet", në versionin serbisht shfaqen vetëm shtatë departamente, ndërsa në versionin shqip janë të renditura madje 36, me përshkrime të detajuara.

Për sa i përket subvencioneve, pothuajse të gjitha dokumentet janë të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe. Shumica janë të padisponueshme për shkarkim ose mungojnë krejtësisht në gjuhën serbe. Edhe seksioni i legjislacionit është asimetrik: në versionin serbisht mungojnë disa kategori, ndërsa informacionet për ligje, udhëzime administrative dhe strategji janë minimale ose nuk ekzistojnë. Në skedën për tenderë, asnjëri nga nëntë dokumentet në serbisht nuk është realisht në atë gjuhë; disa nuk mund të shkarkohen, ndërsa kategoria "Kontratat" nuk ekziston fare. Gjithashtu, udhëzuesit online për grante dhe aplikime janë të disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe.

Në rrjetet sociale, ministria kryesisht komunikon në shqip. Në Facebook, emri dhe teksti hyrës i ministrisë janë vetëm në shqip, ndërsa postimet janë pothuajse ekskluzivisht në të njëjtën gjuhë, me përjashtim të disa njoftimeve për subvencione dhe grante që ndonjëherë përkthehen në serbisht. Materialet video dhe fushatat promovuese janë gati krejtësisht në shqip, me përjashtime të rralla që lidhen me veriun e Kosovës. Në X (ish-Twitter), e gjithë përmbajtja është vetëm në shqip, ndërsa në kanalin e ministrisë në YouTube vërehet një përfaqësim pak më i madh i serbishtes, megjithatë shumica e materialeve janë në shqip, pa përkthim ose përshkrim bazë në gjuhën serbe.

Mungesa e informacionit, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve tjera me rëndësi kyç në gjuhën serbe ndikon drejtpërdrejt te qytetarët që komunikojnë në këtë gjuhë, duke kufizuar mundësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në programet dhe përfitimet që ofron Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Meqenëse ligji parashikon qartë qasje të barabartë në informacione në të dyja gjuhët zyrtare, një praktikë e tillë përbën jo vetëm shkelje të detyrimeve ligjore, por edhe diskriminim të komuniteteve të caktuara në qasjen e tyre në subvencione, grante dhe stimuj të tjerë që kjo ministri i ofron përmes Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË
BUXHETI (MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL): **93.562.272 EURO**

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: **NUK KA TË DHËNA**
NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: **NUK KA TË
DHËNA**

Analiza e detajuar e uebsajtit zyrtar të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ka nxjerrë në pah mangësi të mëdha në qasjen dhe cilësinë e informacionit në gjuhën serbe, gjë që tregon se ka probleme serioze në zbatimin e parimeve të barazisë së gjuhëve zyrtare.

Në seksionin “Rreth nesh”, i cili do të duhej të ofronte informacionet bazë mbi agjencinë, versioni në gjuhën serbe është plotësisht bosh dhe nuk përmban as të dhëna elementare për kompetencat dhe kuadrin themelues, ndërsa versioni në gjuhën shqipe ofron një pasqyrë të plotë dhe të detajuar. E njëjta gjë vërehet edhe tek organogrami, i cili është paraqitur vetëm në gjuhën shqipe, pa asnjë përkthim në serbisht.

Informacionet mbi drejtorin ekzekutiv të agjencisë mungojnë krejtësisht në gjuhën serbe, pasi nuk ekziston as kategoria përkatëse në këtë version të uebsajtit, ndërkohë që në gjuhën shqipe ofrohet biografia dhe e gjithë përvoja profesionale. Galeritë e videove tregojnë mungesë të përditësimit, me vetëm pak materiale të publikuara, ndër të cilat e vetmja video e etiketuar si në serbisht është në fakt në shqip, përfshirë edhe titullin.

Në kategorinë “Politika e Privatësisë”, versioni në gjuhën serbe nuk përmban asgjë, ndërsa ai në gjuhën shqipe ofron tekst të plotë dhe të përditësuar. E njëjta gjendje paraqitet te seksioni “Raporte dhe Publikime”, ku në versionin serbisht mungojnë dokumente e materiale, megjithëse kategoria është e dukshme, ndërsa faja në shqip përmban të gjithë dokumentacionin nga viti 2013 deri në vitin 2025.

Një nga shembujt më të qartë të shkeljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve është kategoria “Kontakti”, e cila në gjuhën serbe nuk përmban asnjë të dhënë kontakti, duke e pamundësuar për përdoruesit serbë qasjen në informacionet bazë për projektet, grantet dhe zyrat rajonale. Në anën tjetër, versioni në shqip ofron të gjitha këto të dhëna në mënyrë të qartë.

Kategoria “Lajme” reflekton një disproporcion të theksuar: mbi 80 lajme në gjuhën shqipe kundrejt vetëm tre lajmeve në serbisht. Situata është edhe më drastike te kategoria “Departamentet”, ku versioni në gjuhën serbe nuk përmban asnjë informacion, ndërsa ai në shqip ofron përshkrim të detajuar të kompetencave dhe kontaktet e drejtorive.

Në segmentin e legjislacionit ekziston një mospërputhje e madhe: në shqip janë publikuar 38 dokumente, ndërsa në serbisht vetëm gjysma e tyre. Disproporcion i ngjashëm është vërejtur edhe në kategoritë “Udhëzime për aplikim”, “Formularë”, “Programet e veçanta”, si dhe në seksionet që lidhen me grantet dhe subvencionet. Për shumë vite mungojnë dokumentet në gjuhën serbe, ndërkohë që versioni në shqip është i plotë dhe i përditësuar. Cilësia e përkthimeve në serbisht gjithashtu paraqet problem, me gabime të shpeshta drejtshkrimore dhe terma të pakuptueshëm, gjë që e vështirëson më tej shfrytëzimin e materialeve.

Veçanërisht shqetësuese është mungesa e dokumenteve në kategorinë “Lista e Përfituesve”: në gjuhën shqipe dokumentet publikohen rregullisht për periudhën 2019–2024, ndërsa në serbisht nuk ka asnjë dokument përveç vetë emrit të kategorisë.

Në lidhje me konkurset për punësim, numri i dokumenteve në shqip tejkalon shumëfish numrin e atyre në serbisht, ndërsa përkthimet ekzistuese në serbisht janë me cilësi të dobët dhe plot gabime, duke i bërë ato të pavlefshme për përdorim. Po ashtu, ndërsa konkurset në shqip janë të disponueshme për dhjetë vitet e fundit, në gjuhën serbe ato ekzistojnë vetëm për gjashtë vitet e fundit.

Në rrjetet sociale, faja zyrtare e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Facebook është e qasshme vetëm në gjuhën shqipe, me publikime ekskluzivisht në këtë gjuhë. Materialet video në gjuhën serbe reduktohen në vetëm dy video të vitit 2020, ndërsa të gjitha përmbajtjet tjera janë vetëm në shqip. Kanali zyrtar në YouTube nuk përmban asnjë material, megjithëse është krijuar qysh në vitin 2015. Vegëzat për në rrjetet sociale X (ish-Twitter) dhe Instagram ekzistojnë, por dërgojnë në faqe joaktive ose inekzistente.

Mungesa e informacionit në gjuhën serbe mbi projektet, grantet dhe subvencionet që zbaton Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës ka pasoja të drejtpërdrejta për qytetarët, veçanërisht për bujqit, të cilëve u pamundësohet qasja në përmbajtje në gjuhën e tyre. Kjo praktikë kufizon mundësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në programet e mbështetjes që kjo agjenci realizon në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në një situatë ku informacionet me rëndësi kyç, si konkurset publike, kriteret e aplikimit, afatet dhe mënyrat e paraqitjes, nuk janë të qasshme në gjuhën që ata e kuptojnë, qytetarët nga komunitetet që komunikojnë në gjuhën serbe përjashtohen në mënyrë sistemore nga një proces që duhej të ishte përfshirës dhe transparent. Kjo jo vetëm që shkel parimin e mundësive të barabarta, por edhe thellon pabarazitë ekzistuese ndërmjet komuniteteve në qasjen në burimet ekonomike dhe në mbështetjen për zhvillimin e zonave rurale.

MINISTRIA E EKONOMISË

BUXHETI: 58,6 MILIONË EURO

NUMRI I PUNONJËSVE: 137

(5 NGA KOMUNITETET JO-SHUMICË)

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: 0

(“PËRKTHYES TË JASHTËM” TË ANGAZHUAR, NUMRI I TYRE NUK ËSHTË I PËRCAKTUAR)

Analiza e uebsajtit zyrtar të Ministrisë së Ekonomisë ka zbuluar mangësi të konsiderueshme në qasjen dhe cilësinë e informacionit në gjuhën serbe, me shembuj të shumtë të mospërputhjes dhe shkëljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Në seksionin kushtuar zëvendësministrave, versioni në serbisht nuk ofron informacione për një zëvendësministër, të cilat paraqiten në mënyrë të rregullt në versionin shqip. Organogrami i ministrisë është i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa mungon plotësisht në versionin serbisht.

Kategoritë si “Komisioni Ndërmintor për NP” dhe “Komisioni Ndërmintor për Privatizim – NP” në versionin serbisht përmbajnë informacione minimale ose janë plotësisht bosh, ndërkohë që versioni shqip ofron të dhëna të detajuara. Situatë e ngjashme paraqitet edhe në seksionet “Ndërmarrjet Publike Qendrore” dhe “Ndërmarrjet Publike Rajonale të Ujitjes dhe Ujësjellësit”, ku në serbisht shfaqen vetëm titujt pa përmbajtje.

Mospërputhje të ngjashme evidentohen në seksionin e uebsajtit kushtuar Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Njësisë së Inspektimit të Energjisë, ku versioni në serbisht përmban dukshëm më pak informacion sesa versioni në shqip. Projekte të tilla si “BRE” dhe ato në kuadër të Komunitetit të Energjisë janë gjithashtu të përfaqësuara në mënyrë të pamjaftueshme ose jofunksionale në gjuhën serbe.

Kategoria “Dokumente Strategjike” pasqyron disproporcion të madh në numrin e dokumenteve në dispozicion: 29 në shqip dhe vetëm 13 në serbisht, ndërsa raporti i fundit vjetor në serbisht daton nga viti 2016. Aplikimet për punësim, projektet dhe publikimet janë kryesisht të padisponueshme ose të përkthyer dobët në gjuhën serbe, gjë që vështirëson ose pamundëson një sërë aktivitete të mundshme për qytetarët që flasin këtë gjuhë.

Në fushën e energjisë, dokumentet që lidhen me projektin e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme mungojnë krejtësisht në versionin serbisht, ndërkohë që në shqip ofrohen të dhëna të detajuara, përfshirë menaxhimin dhe debatet publike.

Aktet nënligjore, udhëzimet administrative, rregulloret dhe dokumentet mbi minierat janë dukshëm më pak të përfaqësuara ose mungojnë fare në serbisht, krahasuar me versionin shqip.

Galeria e videove në gjuhën serbe është shumë më e varfër – vetëm shtatë video, prej të cilave tri janë të titulluara në gjuhën shqipe. Edhe rrjetet sociale të Ministrisë së Ekonomisë pasqyrojnë këtë disproporcion gjuhësor. Faqja zyrtare në Facebook përdor vetëm gjuhën shqipe, me video materiale pothuajse pa përkthim në serbisht, përveç rasteve të rralla me titra për përmbajtje që lidhen me veriun e Kosovës. Në X (ish-Twitter) nuk ka asnjë postim në gjuhën serbe, ndërsa kanali në YouTube pothuajse nuk përmban përmbajtje në këtë gjuhë, as përkthime apo titra.

Në kuadër të monitorimit, iu drejtuam Ministrisë së Ekonomisë me pyetje shtesë, dhe si përgjigje u raportua se numri i përgjithshëm i të punësuarve është 137 (132 nga komuniteti shqiptar, një nga komuniteti turk, një nga komuniteti ashkali dhe tre nga komuniteti serb). Megjithatë, për sa i përket numrit të përkthyesve të kualifikuar për gjuhën serbe, ministria deklaroi se kanë të angazhuar “përkthyes të jashtëm” për gjuhën serbe dhe angleze, por se numri i tyre “nuk është i përcaktuar”.

Respektimi i përdorimit të gjuhës serbe në Ministrinë e Ekonomisë tejkalon një detyrim thjesht administrativ. Ky është një problem themelor që ndikon drejtpërdrejt në kushtetutshmërinë e funksionalitetin e sistemit, por edhe në kohezionin socio-ekonomik të shoqërisë. Aplikimi joadekuat i dygjuhësisë gjeneron barriera sistimore që minojnë parimet e barazisë, transparencës dhe sigurisë juridike për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata nga komunitetet që komunikojnë në gjuhën serbe. Mosrespektimi i dispozitave ligjore dhe kushtetuese për gjuhët në këtë ministri krijon një çekuilibër të drejtpërdrejtë për sa i përket qasjes në informacionet dhe burimet vitale. Për shembull, qasja në informacionet mbi mundësitë ekonomike dhe mbështetjen bëhet/mbetet selektive.

Mungesa e informacionit gjithëpërfshirës në gjuhën serbe mbi konkursat për subvencione, programet për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, stimujt apo rregulloret specifike për investime, përjashton në mënyrë efektive një pjesë të konsiderueshme të popullsisë nga pjesëmarrja aktive në jetën ekonomike. Problemi manifestohet gjithashtu edhe në transparencën e proceseve të punësimit. Dygjuhësia joadekuat në konkursat për vende pune, përshkrimet e punës dhe formularët e aplikimit në kanalet zyrtare diskriminon pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhën serbe në qasjen e tyre në shërbimet publike. Kjo jo vetëm që cenon parimin e barazisë, por edhe e privon institucionin nga mundësia për të tërhequr kuadro më cilësore nga të gjitha komunitetet.

KUVENDI I KOSOVËS

BUXHETI: 11,701,185 EURO

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: NUK KA TË DHËNA

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR:

NUK KA TË DHËNA

Analiza e përmbytjes së uebsajtit zyrtar të Kuvendit të Kosovës tregon për një sërë mangësish në aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, veçanërisht në aspektin e qasjes në informacione dhe dokumente në gjuhën serbe. Edhe pse serbishtja, krahas shqipes, është gjuhë zyrtare në Kosovë, një pjesë e madhe e përmbytjes së dedikuar versionit të uebsajtit në serbisht mungon, nuk është përkthyer, ose është përkthyer pjesërisht dhe në mënyrë jo-konsistente.

Informacionet që qytetarët kanë në dispozicion në kuadër të kategorisë “Dokumentet e Pavarësisë”, në versionin serbisht të uebsajtit, përveç titullit, nuk ekziston asnjë dokument, ndërsa në versionin shqip të gjitha dokumentet janë të disponueshme në mënyrë të rregullt. Në kategoritë si “Projektligjet” dhe “Ligjet”, dokumentet janë kryesisht të përkthyer, por disa tituj mbeten vetëm në gjuhën shqipe. Situata e ngjashme është evidentuar edhe në seksionet “Punësimi”, “Prokurimi”, “Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë” dhe “Legjislaturat e kaluara”, ku përmbytja është e paplotë ose mungon tërësisht në gjuhën serbe. Biografia e kryetarit të Kuvendit, në versionin serbisht, përmban vetëm informatat më themelore – emrin, mbiemrin dhe funksionin. Në kategori të tjera, si “Memorandum”, “Analizë buxhetore”, “Plani Strategjik”, “Forumi për Transparencën Parlamentare” dhe “Hulumtimet legjislative”, vërehet mungesë e plotë e dokumenteve në gjuhën serbe ose një numër dukshëm më i vogël i tyre në krahasim me versionin e uebsajtit në gjuhën shqipe.

Gjithashtu, kategoritë si “Bashkëpunimi ndërkombëtar” dhe “Seancat” në serbisht janë të paplota ose nuk përmbajnë fare përmbytje, ndërkohë që pjesërisht shfaqen tekste në gjuhën angleze, e cila nuk është gjuhë zyrtare. Edhe në kategorinë “Për media” mungon një nënkategori me rëndësi – “Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës”, e cila ekziston në versionin shqip.

Kur bëhet fjalë prezencën në rrjete sociale, situata është disi më e favorshme. Në faqen e Kuvendit në Facebook, një pjesë e informacioneve dhe materialeve video, si urimet dhe fushatat, janë të qasshme edhe në gjuhën serbe. Megjithatë, transmetimet e seancave ende nuk kanë përkthim. Në kanalin e Kuvendit në YouTube, edhe pse ekziston një pjesë e materialeve në gjuhën serbe, transmetimet e seancave dhe deklaratat e deputetëve publikohen ekskluzivisht në gjuhën shqipe, pa përkthim.

Si organi më i lartë ligjvënës, Kuvendi i Kosovës ka rol kyç në zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, përfshirë Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ky institucion duhet të vendosë standarde të transparencës, barazisë dhe qasjes për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë gjuhësore. Respektimi i të drejtave gjuhësore, sidomos në institucione si Kuvendi, ndikon drejtpërdrejt në besimin e komuniteteve pakicë në institucionet e sistemit. Duke qenë se serbishtja, krahas shqipes, është gjuhë zyrtare në Kosovë, prania e saj konsistente në punën dhe komunikimin e Kuvendit nuk është çështje teknike, por detyrim ligjor. Mosrespektimi i këtij detyrimi dërgon mesazh përjashtues dhe nxit ndjenjën e pabarazisë institucionale. Prandaj, aplikimi konsistent i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kuvend përbën themelin për ndërtimin e një shoqërie përfshirëse dhe demokratike.

**MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS**

BUXHETI: 260 MILIONË EURO

NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: NUK KA TË DHËNA

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR:

NUK KA TË DHËNA

Analiza e uebsajtit zyrtar të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka evidentuar shkelje serioze të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, të cilat shfaqen përmes mospërputhjeve të shumta, mungesës së përmbajtjes dhe lënies anash të përmbajtjes në versionin serbisht.

Qysh në ballinën e uebsajtit, emri zyrtar i institucionit nuk është përkthyer në tërësi – në vend të emrit të plotë përdoret vetëm forma e shkurtuar “Ministria e Infrastrukturës”. Në pjesën që i dedikohet ministrit dhe zëvendësve të tij, versioni në gjuhën serbe nuk përmban asnjë informacion apo fotografi, ndërsa në versionin shqip të gjitha këto janë të publikuara në mënyrë të rregullt. Mungesa të ngjashme janë vërejtur edhe në seksionet “Kabineti i ministrit”, “Sekretari i përgjithshëm” dhe “Organogrami”, ku faqet janë bosh ose përmbajnë vetëm tituj (shpesh me gabime gramatikore).

Kategoritë “Lajme”, “Foto Galeria” dhe “Video Galeria” gjithashtu përmbajnë mospërputhje – ndërsa versioni në shqip përditësohet rregullisht, në versionin serb mungojnë vegëzat, tekstet shoqëruese janë në shqip, dhe numri i materialeve video është i papërfillshëm. Mospërputhjet më drastike janë vërejtur në segmentet “Departamentet”, “Konkurse”, “Legjislacioni”, “Tenderë” dhe “Informacione”, ku në versionin serbisht shënohet mungesë e theksuar përmbajtjeje, tituj të papërkthyer, faqe bosh dhe mungesë e informatave themelore që në versionin shqip janë të publikuara në mënyrë të rregullt. Kështu, në kategorinë “Departamentet” figurojnë vetëm tetë segmente, krahasuar me 11 sa janë në versionin shqip. Në kategorinë “Konkurse” janë të qasshme vetëm katër dokumente, përkundër mbi 100 dokumenteve në gjuhën shqipe. Segmenti “Tenderë” në gjuhën serbe është tërësisht bosh, ndërsa në versionin shqip ka mbi dhjetë dokumente.

Brengos fakti se në kategorinë “Legjislacioni” përdoruesit e versionit serbisht të uebsajtit përballen me kategori të papërkthyer dhe mungesën e dokumenteve me rëndësi kyç siç janë ligjet, rregulloret, strategjitë dhe licencat. Mungesa e qasjes së barabartë në informacion veçanërisht vërehet në kategorinë “Informacione”, ku në versionin serbisht janë të qasshme vetëm 15 dokumente, krahasuar me mbi 100 në versionin shqip.

Prania digjitale e ministrisë në rrjete sociale gjithashtu nuk tregon përparim në aspektin e komunikimit dygjuhësh. Në faqen zyrtare të ministrisë në Facebook, e gjithë përmbajtja – përfshirë emrin e faqes, tekstet, videot dhe postimet – është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe. E njëjta gjë vërehet edhe në kanalin zyrtar të ministrisë në YouTube, ku nuk ka asnjë përmbajtje në serbisht dhe as nuk ofrohet përkthim.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si një nga organet kryesore të degës ekzekutive, ka përgjegjësi të veçantë për të siguruar qasje të barabartë në informacion për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga prejardhja gjuhësore. Respektimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në këtë rast nuk është vetëm formalitet, por konfirmim konkret i barazisë dhe përfshirjes institucionale. Kur një pjesë e popullsisë nuk mund të ketë qasje në informacione themelore në lidhje me konkurset, tenderët, legjislacionin ose aktivitetet e ministrisë, lind një ndjenjë përjashtimi dhe marginalizimi.

Kjo jo vetëm që shkel Ligjin për përdorimin e gjuhëve, por shkel edhe parimet themelore të transparencës dhe barazisë që do të duhej të jenë themeli i çdo shoqërie që synon demokraci.

Praktika e institucioneve të Kosovës në komunikimin me mediat që raportojnë në gjuhën serbe shpërfaq mangësi sistematike në sigurimin e barazisë gjuhësore dhe qasjes së barabartë në informacion. Shumë ministri, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Kulturës, shpërndajnë njoftimet e tyre zyrtare ekskluzivisht në gjuhën shqipe. Ngjashëm, Policia e Kosovës në shumicën e rasteve jep informacione vetëm në shqip, ndërsa përkthimet në serbisht, kur ekzistojnë, arrijnë me vonesa prej shumë orësh dhe me mangësi serioze në cilësi, gjë që i bën pothuajse të papërdorshme. Përfaqësuesit e policisë në Prishtinë dhe Graçanicë rrallë janë të qasshëm për mediat serbe në jug të Ibrit, ndërsa në komunikimin me veriun e Kosovës vërehet qasje dukshëm më profesionale. Përgjithësisht në praktikë paraqet Ministria për Komunitete dhe Kthim, e cila rregullisht jep njoftime paralelisht në gjuhën shqipe dhe serbe.

Problem i veçantë vërehet në punën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila deri më tani nuk ka lëshuar asnjë komunikatë, njoftim apo ftesë për konferencë për media në gjuhën serbe. Në mënyrë paradoksale, pikërisht kjo ministri, sipas nënshkrimeve të disponueshme në komunikimin elektronik, është kompetente edhe për Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës. Megjithatë, parashikimi i motit, që u shpërndahet redaksive çdo disa ditë, është në dispozicion vetëm në shqip. Paralajmërimet dhe ankesat e gazetarëve të adresuara tek aktorët e brendshëm dhe ndërkombëtarë gjatë viteve të shkuara nuk kanë sjellë ndryshime. Meqë bëhet fjalë për tekst skajshmërisht të parashikueshëm që reduktohet në 15–20 fjali standarde, është e qartë se shkak nuk qëndron te mungesa e burimeve përkthyes, por te mungesa e vullnetit politik.

Komunikim i pamjaftueshëm është regjistruar edhe në Ministrinë e Bujqësisë, ndonëse bëhet fjalë për një dikaster me rëndësi kyç për ekonominë e Kosovës. Informacionet mbi punën e kësaj ministrie kanë ardhur vetëm herë pas here dhe në mënyrë të tërthortë, kryesisht nga Kabineti i Kryeministrit, por jo drejtpërdrejt nga vetë ministria. Vitin që shkoi është regjistruar vetëm një intervistë që ministri kompetent i ka dhënë një mediumi në gjuhën serbe nga veriu i Kosovës.

Vështirësi shtesë në qasjen në informacion ilustron edhe rasti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i cili gjatë procesit të zgjedhjeve në shkurt 2025 nuk arriti të sigurojë informacione adekuate në gjuhën serbe. Ndërsa njoftimi mbi procedurën e aplikimit për akreditim u publikua në shqip më 12 janar 2025, ai kurrë nuk u përkthye në serbisht. Formulari i aplikimit ishte vetëm pjesërisht i përkthyer dhe atë me cilësi të pamjaftueshme, ndërsa në komunikimin me redaksitë serbe munguan komunikatat dhe njoftimet nga KQZ për konferenca dhe aktivitete të tjera zgjedhore. Kjo praktikë e vështirëson më tej transparencën dhe qasjen e barabartë në procesin e zgjedhjeve, duke zbehur besimin e komunitetit serb në institucione dhe vetë procesin e zgjedhjeve.

Këto probleme u nxorën në pah edhe nga përfaqësues të mediave që raportojnë në gjuhën serbe. Drejtori i Radios Kim, Isak Vorgučić, theksoi: “KQZ për serbët nuk ka siguruar madje as mënyrë të barabartë për t’u akredituar për ndjekjen e zgjedhjeve. Përveç kësaj, ishim dëshmitarë se ata nuk siguruan në mënyrë të duhur numërimin dhe shpalljen e rezultateve. Nuk dërguan as komunikata mediave në gjuhën serbe, as ftesa, kështu që është i qartë mosorganizimi dhe mosinteresimi për të ofruar fare shërbim për mediat serbe, ndërsa kjo është detyrë e tyre.”²⁴

Gjykata Kushtetuese e Kosovës paraqet një shembull të institucionit që në një masë të caktuar tregon praktika të mira për sa i përket respektimit të të drejtave gjuhësore. Uebfaqja zyrtare e këtij institucioni është në masë të madhe i harmonizuar me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, ndërsa komunikimi me mediat që raportojnë në serbisht ka qenë, sipas përvojave të disponueshme, në nivel të lartë.

²⁴ <https://radiokim.net/vesti/drustvo/234768-istrasivanje-medijsko-pracenje-kosovskih-izbora-izborna-kampanja-politicke-stranke-i-uloga-medija/>

ZGjatë gjysmës së parë të vitit 2025, përgjigjet e Gjykatës Kushtetuese ndaj pyetjeve të Radios Kim kanë mbërritur brenda vetëm disa orëve, dhe kjo në gjuhën serbe në mënyrë plotësisht korrekte.

Megjithatë, praktika pozitive në komunikimin me media u zbeh me vendimin e fillimvitit 2025 që mbishkrimi zyrtar i Gjykatës Kushtetuese në shkrimin cirilik të hiqej dhe të zëvendësohej vetëm me mbishkrimin në shkrimin latin. Ky veprim shkaktoi reagime serioze dhe vlerësime për shkelje të të drejtave gjuhësore. Avokatja Gordana Konstantinović me atë rast paralajmëroi: “Është e diskutueshme se si do të veprojnë Gjykata Kushtetuese ndaj shkeljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve, heqjes së tabelave në shkrimin cirilik dhe një lloj gjenocidi gjuhësor që po zbatohet mbi gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.” Sipas saj, pozita e gjuhës serbe dhe shkrimit cirilik në Kosovë nxjerr në pah një vazhdimësi diskriminimi dhe mospërgatitje të vetëdijshme të institucioneve për të zbatuar ligjet që i kanë miratuar vetë. Ajo theksoi se “ky ndryshim i emërimit flet më së miri për fatin e komunitetit serb në Kosovë”.²⁵ Deklarata të tilla pasqyrojnë mosbesimin e thellë të komunitetit serb ndaj kornizës institucionale dhe nënvizojnë edhe më shumë nevojën për aplikimin e qëndrueshëm të normave ekzistuese ligjore. Për dallim nga mangësitë institucionale, disa organizata të shoqërisë civile, pavarësisht burimeve të kufizuara financiare, përpiqen të respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe të sigurojnë qasje të barabartë në informacion. Shumë organizata joqeveritare²⁶ materialet e tyre i publikojnë dhe shpërndajnë rregullisht në tri gjuhë – serbisht, shqip dhe anglisht – duke treguar se barrierat institucionale është para së gjithash çështje e vullnetit politik, e jo e kapaciteteve reale.

²⁵ <https://radiokim.net/vesti/drustvo/232476-uns-ustavni-sud-ukinuo-svoje-ime-na-cirilici-i-tako-prekrasio-ustav-kosova/>

²⁶ <https://radiokim.net/analiza/239077-kosovo-vesti-sistematsko-nepostovanje-zakona-o-upotrebi-jezika-nvo-kao-standard-u-jezickoj-ravnopravnosti/>

SHEMBULL I PRAKTIKËS PJESËRISHT TË MIRË

Është vërejtur se në Kosovë ekzistojnë edhe shembuj të praktikës pjesërisht të mirë, ku disa institucione përpiqen të respektojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, megjithëse ballafaqohen me sfida serioze në gjetjen e përkthyesve të kualifikuar. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një fazë pilot të monitorimit, në këtë raport kemi synuar të paraqesim edhe disa shembuj të praktikave pozitive, të cilat dëshmojnë se, pavarësisht burimeve modeste, është e mundur të sigurohet qasje në informacion për publikun e gjerë në të dyja gjuhët zyrtare. Shembuj të tillë janë të rrallë, por të rëndësishëm për të kuptuar dimensionin e plotë të problemit, pasi dëshmojnë se shkak i thelbësor i mosrespektimit të ligjit është para së gjithash mungesa e vullnetit politik. Si pengesa shtesë identifikohen mungesa e kuadrove profesionale, pagat e ulëta në sektorin publik dhe fakti që angazhimi përmes agjencive e bën punën e përkthyesit më tërheqëse dhe më të leverdishme.

GJYKATA KUSHTETUESE

BUXHETI: 2.179.861,00 EURO

**NUMRI I ZYRTARËVE TË PUNËSUAR: 64 (5 NGA
KOMUNITETET JO-SHUMICË)**

NUMRI I PËRKTHYESVE TË KUALIFIKUAR: 4

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në masë të madhe paraqet shembull pozitiv për sa i përket respektimit të dispozitave ligjore që lidhen me përdorimin e gjuhëve zyrtare. Versioni në gjuhën serbe i uebsajtit zyrtar të këtij institucioni në shumicën e segmenteve pasqyron një shkallë të lartë të përputhshmërisë gjuhësore, qasjes dhe funksionalitetit, duke mundësuar kështu qasje të barabartë në informacion për qytetarët që komunikojnë në gjuhën serbe.

Në ballinë, të gjitha kategoritë kryesore janë të shënuara qartë, ndërsa përmbajtja brenda tyre është e disponueshme në gjuhën serbe dhe është identike me atë në gjuhën shqipe. Veçanërisht i rëndësishëm është fakti se informacionet mbi gjyqtarët, historikun e institucionit, kompetencat, rregulloret, statistikat, publikimet dhe lajmet janë përkthyer në mënyrë konsistente dhe nga aspekti i përmbajtjes janë të harmonizuara në të dy versionet gjuhësore të uebsajtit. Seksione si “Vendimet” dhe “Punësim” gjithashtu meritojnë lëvdatë: përdoruesve u mundësohet shkarkimi i dokumenteve në gjuhën e përzgjedhur, ndërsa funksionalitete si filtrat dhe kërkimi janë të përshtatura në mënyrë të përpiktë për të dyja gjuhët. Edhe të dhënat e kontaktit, si dhe vegëzat me institucione të tjera, janë të paraqitura dhe të përkthyer në mënyrë të rregullt.

Megjithatë, përkundër shembujve të qartë të praktikave të mira, ekzistojnë disa aspekte që cenojnë pamjen e përgjithshme. Në disa kategori, ndonëse dokumentet janë formalisht të titulluara në gjuhën serbe, përmbajtja e tyre mbetet ekskluzivisht në shqip. Ky është rasti me dokumentet në kategoritë “Kushtetuta”, “Ligji për Gjykatën Kushtetuese”, “Rregulloret e brendshme”, “Udhëzim mbi praktikën”, “Rregullorja e Njësisë Ligjore”, si dhe “Kodi i etikës”. Gjithashtu, formulari për punësim, megjithëse i titulluar në gjuhën serbe, është i tëri në gjuhën shqipe.

Situatë e ngjashme vërehet edhe për sa i përket përmbajtjeve video, si në uebsajt, ashtu edhe në rrjetet sociale. Edhe pse komunikimi tekstual në profilin e Gjykatës në Facebook në mënyrë konsistente bëhet në të dyja gjuhët, shumica e materialeve video janë të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, pa titra ose përkthim në gjuhën serbe. Në kanalin e Gjykatës në YouTube vërehet një praktikë e pjesshme e dygjuhësisë, ndërsa në platformën X (ish-Twitter) përmbajtja publikohet vetëm në gjuhën angleze, duke anashkaluar kështu përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunikimin digjital.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore dhe është kompetente për interpretimin e Kushtetutës dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, akteve dhe vendimeve të institucioneve të tjera. Si e tillë, ajo ka për detyrim që në punën e saj të pasqyrojë parimet themelore kushtetuese, përfshirë edhe parimin e barazisë gjuhësore. Respektimi i plotë i normave gjuhësore nga ana e Gjykatës Kushtetuese është posaçërisht i rëndësishëm, ngase ky institucion merret me çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat e qytetarëve, përgjegjësinë institucionale dhe funksionimin e rendit juridik. Prandaj, transparenca, qasja dhe besimi i publikut në punën e saj nuk mund të realizohen plotësisht nëse një pjesë e qytetarëve nuk ka qasje të barabartë në informacione në gjuhën e tyre.

Është pra me rëndësi thelbësore që të gjitha informacionet, përfshirë aktgjykimet, komunikatat, njoftimet, vendimet, si dhe përmbajtjet digjitale në uebsajt dhe rrjetet sociale, të jenë të sinkronizuara dhe të qasshme në të dy gjuhët zyrtare. Në këtë mënyrë, jo vetëm që përmeshen detyrimet ligjore, por edhe forcohet legjitimiteti dhe përfshirja e institucionit në një shoqëri shumëtnike.

Pavarësisht mangësive të përmendura, Gjykata Kushtetuese e Kosovës mbetet një nga shembujt e rrallë të institucioneve që tregojnë shkallë të lartë të vullnetit institucional për të siguruar trajtim të barabartë gjuhësor dhe aplikim të detyrimeve ligjore në sferën digjitale. Përmirësime të mëtejshme, sidomos në segmentin e dokumenteve dygjuhëshe dhe përmbajtjeve multimediale, do të kontribuonin në përputhshmërinë e plotë me normat e barazisë gjuhësore.

SHËMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË ORGANIZATAT JO-QEVERITARE SI STANDARD I BARAZISË GJUHËSORE

27

Analiza e prezantimit në internet të organizatave joqeveritare të komunitetit serb që veprojnë në Kosovë tregon një nivel të lartë përputhshmërie me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe përkushtim ndaj parimeve të qasjes së barabartë në informacion. Qysh në ballinat e uebsajteve, është mundësuar navigacion i qartë dhe funksional mes tri gjuhëve – serbishtes, shqipes dhe anglishtes. Kjo zgjidhje siguron trajtim të barabartë për të gjithë përdoruesit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre gjuhësore, dhe paraqet shembull pozitiv se si mjetet digjitale mund të kontribuojnë në përfshirjen gjuhësore.

Në të gjitha kategoritë e analizuara, nga misioni dhe vizioni i organizatave, informacionet mbi selitë, ekipet dhe fokusin tematik, deri te projektet konkrete dhe publikimet, përmbajtja është përkthyer në mënyrë konsistente dhe është e harmonizuar plotësisht në të gjitha gjuhët. Veçanërisht dallon rubrika e lajmeve, ku të gjitha postimet – njoftimet për ngjarje, raportimet nga terreni, komunikatat dhe analizat – janë të disponueshme në serbisht, shqip dhe anglisht, pa ndryshime përmbajtjesore, mangësi ose përkthime selektive.

Kategoria „Projekte“ dëshmon gjithashtu për transparencën dhe përgatitjen e kujdesshme të përmbajtjeve shumëgjuhëshe. Të gjitha informacionet mbi projektet e implementuara dhe ato në vazhdim – përfshirë qëllimet, aktivitetet, donatorët dhe partnerët – paraqiten të plota në tri gjuhë, pa përjashtime. E njëjta gjë vlen edhe për segmentin e publikimeve, ku të gjithë dokumentet relevante, si raporte, hulumtime dhe studime tematike, janë të disponueshme në të njëjtën masë dhe cilësi në të gjitha gjuhët. Disa publikime trajtojnë edhe temën e të drejtave gjuhësore, duke konfirmuar kështu përputhshmërinë mes vlerave të deklaruara dhe praktikës së tyre organizative.

Shumëgjuhësia është evidente edhe në komunikimin digjital jashtë uebsajteve zyrtare. Në rrjetet sociale – Facebook, Instagram, X (ish-Twitter) dhe YouTube – OJQ-të në mënyrë konsistente publikojnë përmbajtje në të tria gjuhët. Qoftë në postime tekstuale, vizuale, infografikë, video apo storie, për secilën përmbajtje sigurohet qasje e barabartë dhe e përshtatur për të gjitha komunitetet gjuhësore. Në disa raste, madje edhe titrat e videove janë sinkronizuar me kujdes, duke rritur më tej qasjen.

Kjo praktikë tregon se aplikimi konsistent i të drejtave gjuhësore nuk është vetëm detyrim ligjor, por edhe shprehje e kulturës institucionale dhe e përfshirjes. Ndonëse me buxhete dhe burime shumë më të vogla sesa institucionet e Kosovës, OJQ-të vendosin një standard që edhe institucionet publike mund ta ndjekin për të siguruar qasje të barabartë në informacion për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh gjuhën që përdorin.

²⁷ <https://ngoaktiv.org/vesti/sistematsko-nepostovanje-zakona-o-upotrebi-jezika-nvo-kao-standard-u-jezickoj-ravnopravnosti/>

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mosrespektimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë nuk përbën thjesht një lëshim teknik. Ai simbolizon pozitën e komuniteteve jo-shumicë në shoqëri dhe shkallën reale të (mos)përfshirjes së tyre në proceset institucionale. Të drejtat gjuhësore nuk janë formalitet, por përbëjnë një element thelbësor të barazisë, sigurisë juridike dhe besimit në institucione. Bazuar në monitorimin e realizuar, është e qartë se Ligji nuk aplikohet në mënyrë konsistente, sistematike dhe transparente. Shumë institucione nuk kanë përkthyes, e as procedura të brendshme që do të garantonin përkthim të rregullt dhe cilësor të përmbajtjeve. Informacionet shpesh publikohen vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa aty ku ka përkthim, ai shpesh është i pasaktë, i pjesshëm ose i palexueshëm, duke e zhveshur kështu shumëgjuhësinë nga kuptimi që ka.

Një problem shtesë është mungesa e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në vetë institucionet publike, si dhe mungesa e mekanizmave që do të mundësonin pjesëmarrjen e tyre aktive në administratën publike. Mungesa e Komisionerit për Gjuhët krijon një vakum institucional në fushën e mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të drejtave gjuhësore, duke e bërë edhe më të vështirë vendosjen e përgjegjësisë dhe trajtimin e mangësive sistemore. Njëkohësisht, mungesa e transparencës në punë, mosdhënia e përgjigjeve ndaj kërkesave e pyetjeve dhe mospublikimi i raporteve adekuate dëshmojnë se niveli i vullnetit institucional për ta trajtuar seriozisht këtë çështje është i ulët.

Pa hapa vendimtarë institucionalë dhe një përcaktim të qartë strategjik, është e vështirë të flitet për përfshirje të mirëfilltë dhe respektim të të drejtave të njeriut. Ndryshimi i gjendjes aktuale kërkon jo vetëm përmirësime teknike, por edhe kuptim qenësor të rëndësisë së barazisë gjuhësore si themel i një shoqërie demokratike. Për sa kohë që të drejtat gjuhësore vazhdojnë të trajtohen si dytësore ose jo të detyrueshme, komunitetet jo-shumicë do të vazhdojnë të mbeten në margjina të jetës politike, administrative dhe shoqërore.

REKOMANDIME

Për të përmirësuar aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë dhe për të siguruar qasje të barabartë në informacion për të gjithë qytetarët, rekomandohet të futet rishikimi i detyrueshëm gjuhësor i të gjitha përmbajtjeve para publikimit në kanalet zyrtare të institucioneve, në mënyrë që të parandalohet përsëritja e gabimeve dhe lëshimeve të shpeshta në përkthim. Është gjithashtu e nevojshme të forcohet roli institucional të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, duke përfshirë plotësim-ndryshime ligjore që do t'i jepnin kompetenca më të mëdha në monitorimin dhe sanksionimin e mosrespektimit të ligjit. Gjithashtu, futja e mekanizmave sistemorë të kontrollit të aplikimit të Ligjit, për shembull përmes rolit të Avokatit të Popullit, do të mund të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve. Element kyç është trajnimi i rregullt i shërbyesve civilë mbi detyrimet që lidhen me të drejtat gjuhësore, si dhe angazhimi i detyrueshëm i kuadrove të kualifikuara për përkthim, si brenda vetë institucioneve, ashtu edhe përmes kontratave transparente me bashkëpunëtorë të jashtëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet platformave digjitale, të cilat shpesh përbëjnë kontaktin e parë të qytetarëve me institucionet; prandaj është e domosdoshme të zhvillohen standarde teknike për shumëgjuhësi në uebsajte dhe rrjete sociale. Po ashtu, rekomandohet publikimi i rregullt i raporteve vjetore mbi aplikimin e Ligjit në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe hartimi i protokolleve dhe udhëzuesve të qartë për të gjitha institucionet që komunikojnë me publikun. Përmirësimi i komunikimit me komunitetet që flasin serbisht dhe gjuhë të tjera zyrtare duhet të jetë pjesë e një politike të gjerë institucionale të transparencës, qasjes dhe barazisë në ushtrimin e të drejtave.

INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE

Të realizohet monitorim i brendshëm në nivel të institucioneve qendrore dhe agjencie, me qëllim harmonizimin e mospërputhjeve gjuhësore ndërmjet dy gjuhëve zyrtare.

Të futet rishikimi i detyrueshëm gjuhësor i të gjitha përmbajtjeve para publikimit në kanalet zyrtare, në mënyrë që të reduktohen gabimet dhe lëshimet në përkthim. Rishikimi do të duhej të kryhet nga lektorë të emëruar posaçërisht në secilin institucion.

Të sigurohet kontrolli sistemor i aplikimit të Ligjit nga Avokati i Popullit dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët. Mospërputhjet me ligjin duhet të dokumentohen qartë dhe të shoqërohen me rekomandime dhe afate për korrigjim, përmes raporteve tremujore të detyrueshme.

Të forcohet roli i Zyrës së Komisionerit për Gjuhët përmes plotësim-ndryshimeve ligjore, të cilat do t'i jepnin kompetenca më të gjera për monitorimin dhe sanksionimin e mosrespektimit të ligjit.

Të angazhohet numër i mjaftueshëm i përkthyesve të kualifikuar brenda institucioneve përmes planifikimit buxhetor, ose përmes konkurseve publike dhe transparente për kontrata bashkëpunimi me palë të treta.

Të zhvillohen standarde teknike për shumëgjuhësi në uebsajtet zyrtare dhe rrjetet sociale, duke përfshirë publikimin e detyrueshëm njëkohësisht në dy gjuhët zyrtare, dukshmërinë e gjuhëve në faqen kryesore dhe kontrollin e saktësisë së përkthimit përmes zgjidhjeve softuerike.

Të publikohen rregullisht raporte gjashtëmujore dhe vjetore mbi aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe të hartohen protokolle të qarta për të gjitha institucionet zyrtare që komunikojnë me publikun.

MEDIAT NË GJUHËN SERBE

Të rritet përgjegjësia për sigurimin e përmbajtjes shumëgjuhëshe, ku redaksitë do të duhej të kërkojnë patjetër nga institucionet e pushtetit qendror dhe lokal të dërgojnë versione dygjuhësore të të gjitha njoftimeve zyrtare.

Të vendosen procedura të qarta të brendshme për kontrollin sistematik të përkthimeve dhe terminologjisë në dokumentet zyrtare dhe në komunikimin e institucioneve, me qëllim sigurimin e konsistencës dhe parandalimin e anomalive gjuhësore.

Të avokohet në mënyrë aktive për aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve përmes shkrimeve gazetareske, storieve hulumtuese dhe debateve mediatike, duke nxjerrë në pah rastet e shkeljes së ligjit.

SHOQËRIA CIVILE

Të formohet një platformë e përbashkët e organizatave joqeveritare dhe mediave, e cila do të ndjekë në mënyrë sistematike aplikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në nivel qendror dhe lokal, me publikimin e raporteve tremujore dhe përgatitjen e një analize vjetore mbi gjendjen e të drejtave gjuhësore.

Të mblidhen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike shembuj nga jeta e përditshme, që lidhen me detyrimet e përcaktuara me ligj për aplikimin konsistent të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Të ofrohet mbështetje për komunitetet në raportimin e rasteve të mosrespektimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Të organizohen fushata publike në rrjete shoqërore me qëllim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e të drejtave gjuhësore dhe qasjes në informacion në gjuhët zyrtare.

Të forcohet bashkëpunimi me mediat, institucionet dhe bashkësinë ndërkombëtare për të nxitur përmirësimin e praktikave në aplikimin e ligjit.poštovanja zakona.

QYTETARËT

Të inkurajohen qytetarët të shfrytëzojnë në mënyrë aktive mekanizmat institucionalë ekzistues për raportimin e rasteve të shkeljes së të drejtave gjuhësore, në mënyrë që të sigurohet përgjegjësi më e madhe e institucioneve dhe mbrojtje më efikase e këtyre të drejtave.

Të vendoset komunikim i rregullt dhe i dyanshëm ndërmjet qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes së dyfishtë në rastet e raportuara të shkeljes së të drejtave gjuhësore dhe rritjes së transparencës në trajtimin e tyre.

BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE

Të sigurohet mbështetje profesionale, teknike dhe financiare për institucionet me qëllim të ndryshimit gradual dhe sistematik të praktikës ekzistuese, duke u fokusuar në ndërtimin e një modeli konsistent dhe praktik për respektimin e qëndrueshëm të dygjuhësisë në Kosovë.

Të përfshihet çështja e aplikimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në raportet dhe vlerësimet e rregullta për progresin e Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut të komuniteteve jo-shumicë, si dhe në vlerësimet për shkallën e sundimit të ligjit. Kjo do të siguronte harmonizim me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, si dhe me detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian.

Të inkurajohet qeveria të miratojë një plan veprimi për zbatimin e programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit për përkthyes dhe ekspertë gjuhësorë, duke përfshirë edhe marrjen e një vendimi për ofrimin e bursave për profesionistët e rinj, me qëllim vendosjen e standardeve cilësore të larta për aplikimin e gjuhëve në sektorin publik. Në këtë mënyrë do të nxitet përfshirja dhe respektimi i të drejtave të komuniteteve pakicë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

INIZIATIVE
PUBBLICHE
RISOLVE
OGGI PER
DOMANI LAUREA